



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr: 16/198
Datë: 02.04.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 13 të Udhëzimit administrativ Nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Miratohet Plani Strategjik për Zhvillimin e Sistemit të Informimit Shëndetësor 2024-2030.
- Obligohet Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Planit Strategjik nga pika 1. e këtij Vendimi.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë/Ministarstvo Zdravstva/Ministry of Health

PLANI STRATEGJIK PËR ZHVILLIMIN E SISTEMIT TË INFORMIMIT SHËNDETËSOR

2024 - 2030

Prishtinë, Mars, 2024

Përmbajtja

1.	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE.....	5
2.	HYRJE.....	8
3.	METODOLOGJIA.....	9
4.	SFONDI.....	10
5.	OBJEKTIVAT.....	22
6.	ARANZHIMET E ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT	26
6.1.	Monitorimi i zbatimit të planit strategjik	27
6.2.	Vlerësimi i zbatimit të Planit strategjik.....	29
7.	NDIKIMI BUXHETOR DHE ZBATIMI I STRATEGJISË.....	30

SHKURTESAT DHE AKRONIMET

AIS, ASHI	Agjencia për Shoqërinë e Informacionit
ARBK	Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës
BHIS	Sistemi i Informimit bazë shëndetësor
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
COTS	Komercial nga rafti
ARC	Agjencia e Gjendjes Civile
DSHB	Departamenti i Shëndetësisë së Burgjeve
DSIS	Departamenti i Sistemit Informimit Shëndetësor të MSH
DWH	Depo e të dhënave
EHR	Kartela elektronike e shëndetit
EPPV	Sistemi i monitorimit të efekteve të padëshiruara pas vaksinës
ERP	Planifikimi i burimeve të ndërmarrjes që një organizatë përdor për të mbledhur, ruajtur, menaxhuar dhe interpretuar të dhëna
ESB	Kanali i shërbimit dhe nivelit të bashkëpunimit” interprise”
MFK	Qendra e Mjekësisë Familjare
FMIS	Sistemi Informimit i menaxhimit financiar
GWP	Kontributet bruto
HFA	Agjencia e Financimit të Kujdesit Shëndetësor
HIE	Shkëmbimi i Informimit shëndetësor
FSSh	Fondi i Sigurimit Shëndetësor
HIFIS	Sistemi Informimit i Sigurimeve Shëndetësore
SISH	Sistemi Informimit Shëndetësor
HMIS	Sistemi i Menaxhimit të Spitalit, Sistemi Informimit i Menaxhimit të Spitalit
HPM	Mekanizmat e blerjes së kujdesit shëndetësor
HW	Hardware
TIK, IT	Teknologjia e Informimit dhe e komunikimit
FSSH	Fondi i Sigurimit Shëndetësor të Kosovës (i njëjtë me HIF)

SHSKUK	Shërbimet Spitalore dhe Klinike Universitare të Kosovës
AKPPM	Agjencia Kosovare e Pajisjeve dhe produkteve mjekësore
MASHT	Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit
MIS	Sistemi i menaxhimit të informacionit
MPMS	Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale
QMF, QKMF	Qendra Mjekësore Familjare, Qendra Kryesore Mjekësore Familjare
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MAP	Ministria e Administratës Publike
QKTGJ	Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut Qendra Kryesore e Kosovës
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Republikës së Kosovës
ODS	Ruajtja e të dhënave operative
OPDBS	Skema e përfitimit të barnave ambulatorore
PAS	Sistemi i administrimit të pacientit
PHF	Objekti i Shëndetit Publik
QRShP	Qendrat Rajonale të Shëndetit Publik
QSHM	Qendra e Shëndetit Mendor
SIMBNJ	Sistemi Informimit Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS)
SMSF	Sistemi i Menaxhimit të Stokut Farmaceutik
SOA	Arkitektura e orientuar drejt shërbimit
SW	Software
ATK	Autoriteti Tatimor i Kosovës
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
UP	Universiteti i Prishtinës

Vërejtje: Shkurtesat dhe akronimet kanë terma profesionalë të teknologjisë informative dhe janë shkëputur nga Studimi i fizibilitetit 2023

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Plani Strategjik për zhvillimin e sistemit të Informimit shëndetësor 2024-2030 është hartuar me qëllim të zhvillimit të mëtejshëm të sistemit të Informimit shëndetësor në Kosovë. Ministria e Shëndetësisë përmes këtij plani strategjik do të rishikojë statusin aktual të zhvillimeve të sistemit të Informimit shëndetësor, për të rivendosur qasjen për arkitekturën kombëtare të shëndetësisë digjitale dhe planet për zhvillimin gjithëpërfshirës të sistemit të Informimit shëndetësor në të ardhmen. Duke pasur parasysh sfidat në zhvillimin e sistemit të Informimit shëndetësor sektorin e shëndetësisë, Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka iniciuar vlerësimin gjithëpërfshirës të sistemit të Informimit shëndetësor, me qëllim të orientimit strategjik të zhvillimit, funksionalizmit dhe integritetit të sistemit të Informimit shëndetësor që paraqet parakushtin esencial të politike bërjes bazuar në dëshmi. Pa zhvillimin e sistemit të Informimit shëndetësor nuk mund të synojmë reformën përmbajtësore të sistemit shëndetësor. Për të përcaktuar rrugën për krijimin e mjedisit për një zhvillim të tillë gjithëpërfshirës, Ministria e Shëndetësisë në vitin 2023 zhvilloi Studimin e Fizibilitetit për sistemin e Informimit shëndetësor në Kosovë që ofroj alternativë për drejtimin strategjik të zhvillimit të SISH e rënë dakord me palët kryesore të interesuara (MSh, Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, Fondi i Sigurimit Shëndetësor, Ofruesit e Kujdesit Shëndetësor Parësor, Sekondar dhe Terciar, QKUK, AKPM, QKTK, Inspektorati Shëndetësor dhe Farmaceutik) në Kosovë. Studimi vjen me rekomandime mbi mënyrat e përdorimit të zhvillimeve aktuale dhe të mëparshme dhe të planifikimit të arkitekturës, të sistemeve dhe të qasjes afatshkurtër dhe afatgjatë.

Të dhënat analitike në dispozicion imponuan domosdoshmërinë për të rekomanduar investimin në një sistem kombëtar të Informimit shëndetësor, që do të mundësojë hapa të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë dhe të sigurisë së shërbimeve shëndetësore për qytetarët e saj në periudhën afatmesme nga viti 2024 deri në vitin 2030. Edhe pse ky synim është ambicioz, ai është i arritshëm me parakushtet që duhet të sigurohen resurset e nevojshme të përcaktuara qartë dhe në detaje në Studimin e Fizibilitetit 2023.

Mbështetur në faktet e sipërpërmendura është projektuar qasja strategjike për zhvillimin e sistemit të Informimit shëndetësor, duke marrë në konsideratë faktorë të ndryshëm si standardet globale në terren, përvojat e vendeve të tjera në ndërtimin e sistemeve të tyre kombëtare e-shëndetësisë dhe specifikën e sistemit shëndetësor në Kosovë. Duke marrë parasysh që aktualisht sisteme mbështetëse, tashmë janë në përdorim në Kosovë përgjithësisht, nuk ka nevojë të tërhiqet ndonjë sistem ekzistues, pasi nuk janë identifikuar probleme apo rreziqe që kërkojnë tërheqjen dhe si të tilla mund të integrohen me sisteme të reja duke iu përmbajtur të gjitha standardeve të ndër operabilitetit. Plani strategjik do të bazohet në vazhdimin e investimit në sistemin BHIS, së bashku me përmirësimet e moduleve, përmirësimet funksionale dhe përmirësimet e infrastrukturës dhe në krijimin e sistemeve mjekësore thelbësore (HMIS; LIS, RIS/PACKS, Sistemi i emergjencës, DSS), zgjidhjet e-shërbimet (EHR, HIE, e-përshkrimi/receta, e-referimi, e-terminet).

Plani Strategjik për zhvillimin e sistemit të Informimit shëndetësor ka një objektivë strategjike:

OBJEKTIVA I: Zhvillimi i sistemit të Informimit shëndetësor

Pjesë përbërëse e Strategjisë është Plani i Veprimit (2024-2026), i cili në mënyrë të detajuar pasqyron aktivitetet që do të realizohen gjatë kësaj periudhe. Plan i Veprimit (PV) i parasheh një riorganizim të qeverisjes dhe të administrimit dhe ngritjen e mekanizmave për planifikim dhe mbikëqyrje që parasheh sigurimin e kërkesave organizative për ekzekutimin e suksesshëm të projekteve të e-shëndetësisë në Kosovë. Plani strategjik për zhvillimin e sistemit të Informimit shëndetësor, në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve administrative, parasheh themelimin e Organit drejtues të e-shëndetësisë, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e të gjitha projekteve digjitale në shëndetësi. Zhvillimi i qeverisjes dhe administrimit parasheh proceset e përgjithshme të administrimit dhe vendimmarrjes që sigurojnë përdorimin efektiv dhe të përgjegjshëm të sistemit të informimit shëndetësor. Kjo kërkon zhvillimin e strukturave të qarta qeverisëse dhe të mekanizmave të llogaridhënies për të mbikëqyrrur zbatimin, funksionimin dhe administrimin e sistemit të Informimit shëndetësor.

Qeverisja do të sigurojë mbikëqyrje iniciativave digjitale në shëndetësi duke përfshirë monitorimin e pajtueshmërisë, vlerësimin e rezultateve dhe sigurimin e përdorimit etik të të dhënave shëndetësore. Zhvillimi i sistemeve mbështetëse parasheh që modulet ekzistuese, duke përfshirë Modulin e profesionistëve shëndetësorë, licencimin e institucioneve private shëndetësore, modulin e menaxhimit të stokut farmaceutik dhe modulet tjera, janë zhvilluar për të plotësuar nevojat specifike dhe punën operacionale të Ministrisë së Shëndetësisë dhe institucioneve të ndryshme shëndetësore. Këto sisteme janë zbatuar në një gamë të gjerë të strukturave të kujdesit shëndetësor dhe përdoren aktivisht nga përdoruesit në aktivitetet e tyre të përditshme të punës. Plani strategjik parasheh investimin në të gjitha sistemet Legacy, së bashku me përmirësimet e moduleve, përmirësimet funksionale dhe përmirësimet e infrastrukturës. Për të siguruar performancën optimale të përdoruesit, është thelbësore të prioritetizohet përmirësimi i moduleve ekzistuese bazuar në informatën kthyesë e përdoruesve dhe zgjidhjen e “buis” të raportuara.

Zhvillimi i sistemeve bazike mjekësore, për të garantuar efikasitetin e regjistrimit elektronik mjekësorë në institucionet shëndetësore do të instalohen gjatë gjithë kësaj faze të zbatimit të planit të veprimit. Kjo do të mundësojë mbledhjen e informacioneve mjekësore të pacientit nga institucionet publike të kujdesit shëndetësor. Përveç instalimit LIS dhe RIS/PACS për institucionet me diagnostikim laboratorik dhe radiologjik, është planifikuar përmirësimi i BHIS dhe zbatimi i mëtejshëm për QKMF, QMF dhe ambulancat, zbatimi i sistemit të informimit të Menaxhimit të Spitaleve (HMIS), LIS dhe RIS/PACS do të bëhet në QKUK dhe spitalet e përgjithshme, vendosja e sistemit të e-Referimit dhe zbatimi i HMIS në të gjitha spitalet, përfundimi i EHR dhe ndërtimi i platformës HIE. Në mënyrë që të sigurohet ndërveprueshmëria ndërmjet komponentëve të ndërtimit, duhet të zbatohet gjithashtu një sistem master i menaxhimit të të dhënave. Sistemi statistikor i Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik dhe Sëmundjeve ngjitëse (IKSHPK) do të fillojë të zhvillohet dhe modifikimet e vazhdueshme të sistemit BHIS dhe sistemeve të tij mbështetëse (sistemi i trashëgimisë, Inspektorati) do të përfundojnë. Një EHR funksionale me të dhëna nga institucionet publike të kujdesit shëndetësor (përveç trajtimit të urgjencës stomatologjike dhe ambulatorë) si dhe një portal funksional për pacientët dhe një sistem e-Referimi duhet të vendoset deri në përfundimin e fazës, e cila është caktuar për vitin 2026. Zhvillimi i sistemeve e-shëndetësisë parasheh krijimin e

mekanizmave ku pacientët do të mund të ndër veprojnë me sistemin e shëndetësisë përmes kanaleve të ndryshme si portali i pacientëve dhe aplikacionet celulare. Përmes zbatimi të aktiviteteve të kësaj objekte specifike do të mundësohet rritja e përqindjes së vizitave të pacientëve në portalin e pacientëve nga përdorimi i portalit të njohuriave për të përmirësuar qasjen në njohuri për menaxhimin më të mirë të gjendjeve të tyre kronike. Ata do të mund të hynë në të dhënat e tyre elektronike të shëndetit (EHR), të caktojnë takime, të marrin receta elektronike dhe të komunikojnë në mënyrë të sigurt me ofruesit e kujdesit shëndetësor si Spitalet, Klinikat dhe Farmacitë, që do të lidhen me sistemin e-shëndetësia nëpërmjet ndërfaqeve ose API-ve të ofruara. Shërbimet kryesore për qytetarët/pacientët – e-Referimi, Portali i pacientëve, sistemet për të mbështetur punën e punonjësve mjekësorë në kujdesin parësor, sekondar dhe terciar – si dhe infrastruktura bazë për sistemin kombëtar e-shëndetësia do të mundësohet me zbatimin e suksesshëm të aktiviteteve nga Faza I. Shumica e vendeve të BE-së që tani kanë sukses në zbatimin e e-shëndetësisë kanë ndjekur të njëjtat hapa (e- Recetë, kujdesi parësor, EHR), duke përfshirë Estoninë, Danimarkën dhe Kroacinë.

Për shkak të synimeve ambicioze me planin strategjik dhe numrit të aktiviteteve të njëkohshme, rreziqet kryesore në këtë fazë janë burimet e kufizuara njerëzore. Mbi këtë është planifikuar zbatimi i plotë i recetës elektronike, si dhe zhvillimi i disa moduleve të reja (Inspektorati, Mbikëqyrja, Zonimi - përzgjedhja digjitale e mjekut, portali i pacientit). Zhvillimi i harduerit parashihet që të sigurohet një infrastrukturë e duhur harduerike (serverët, PC-të, rrjetet, printerat, etj.) që është e rëndësishme kyçe për zhvillimin e sistemit të Informimit shëndetësor. Kjo do të mundësohet përmes një vlerësimi të plotë të infrastrukturës ekzistuese të TI-së dhe identifikimit të përmirësimeve ose investimeve të nevojshme si gjendja e harduerit, aplikacionet softuerike, infrastruktura e rrjetit, kapacitetet e ruajtjes të të dhënave dhe masat e sigurisë të nevojshme për të mbështetur zhvillimi dhe integrimi i sistemit të Informimit shëndetësor. Për më tepër, krijimi i infrastrukturës së nevojshme harduerike është thelbësor për të mundësuar zbatimin e të gjitha aktiviteteve për zhvillim të sistemit të Informimit shëndetësor. Infrastrukturë e fortë teknike duke përfshirë harduerin, softuerin dhe infrastrukturën e rrjetit. Kjo mund të ndihmojë që sistemi të jetë i besueshëm, i sigurt dhe i ndërveprueshëm me sistemet e tjera të kujdesit shëndetësor. Planit strategjik, gjatë fazës së zbatimit (2024-2030), parasheh që harduer të blihet/instalohet gjatë dy viteve të para të periudhës së vëzhguar, për rreth 9% të kostove totale të parashikuara.

Arritja e objektivave strategjike të kësaj strategjie do të sigurohet përmes ndarjes së përgjegjësisë në mënyrë të qartë për zbatuesit, afatizimit të arritjes së objektivave, koordinimit dhe bashkëpunimit me të gjithë hisedarët në sektorin shëndetësor, sigurimin e financimit përmes burimeve të qëndrueshme dhe monitorimit të vazhduar të progresit. Planit strategjik për SISH 2024-2030 ka paraparë edhe sigurinë kibernetike si aspekt i domosdoshëm i sigurisë ku për këtë fushë në baza vjetore do të ndahen 10% e buxhetit të përgjithshëm për SISH. Studimi i fizibilitetit për SISH 2023 do të jetë pjesë integrale e Planit strategjik për SISH 2024-2030.

2. HYRJE

Ministria e Shëndetësisë synon përmirësimin e shëndetit të popullatës së Republikës së Kosovës përmes sigurimit të qasjes universale dhe të barabartë në shërbime shëndetësore cilësore për të gjithë qytetarët e vendit. Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2023-2030 do të shërbejë si udhërrëfyes politik dhe profesional në zhvillimin e sektorit të shëndetësisë që ka për qëllim të ruajë dhe përparoj shëndetin e popullatës si dhe ofrimin e shërbimeve shëndetësore cilësore të arritshme dhe të përballueshme për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Plani Strategjik për zhvillimin e sistemit të Informimit shëndetësor 2024-2030 do të jetë pjesë integrale e Strategjisë Sektoriale e Shëndetësisë 2024-2030. Plani Strategjik për zhvillimin e sistemit të Informimit shëndetësor 2024-2030, bazohet kryesisht mbi bazën e Studimit të fizibilitetit për SISH, i cili është e zhvilluar gjatë vitit 2023 me qëllim të vlerësimit gjithëpërfshirës të kontekstit aktual të sistemit të Informimit shëndetësor dhe ofrimi i orientimit strategjik se në cilin drejtim duhet të zhvillohet sistemi i Informimit shëndetësor.

Digjitalizimi është një nga prioritetet kryesore të vendit, prandaj katër shtyllat e SKZH-së kanë identifikuar objektiva dhe tregues përmes të cilëve synohet të planifikohen intervenime konkrete në sektorë të ndryshëm. Me qëllim të koordinimit të përpjekjeve në të gjithë sektorët e politikave publike, Qeveria e Kosovës si pjesë të kornizës së saj strategjike ka hartuar një dokument të veçantë të quajtur Agjenda Digjitale e Kosovës 2030. Agjenda digjitale është një dokument ndër-sektorial, i cili përcakton politikat dhe prioritetet në kontekst të transformimit të vazhdueshëm digjital të ekonomisë dhe shoqërisë së ndikuar nga teknologjitë inovative dhe trendët globale digjitale. Përmes Agjendës Digjitale 2030, Kosova do të shfrytëzojë zhvillimin e mundësive të teknologjive të avancuara të Informimit dhe të komunikimit për t'u bërë ekonomi dhe shoqëri digjitale dhe për të mbështetur rritjen ekonomike dhe konkurrueshmërinë. Agjenda digjitale adreson shumë sektorë të politikave publike dhe mbulon objektivat, të cilat janë të përfshira ose duhet të përfshihen në strategjitë sektoriale.

Plani Strategjik për zhvillimin e sistemit të Informimit shëndetësor 2024-2030 si pjesë integrale e SSSh 2024-2030, është në përputhje të plotë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2030 që synon të ecë në hap me zhvillimet teknologjike dhe mundësitë që ofron digjitalizimi. Kosova ende nuk ka një sistem funksional të integruar që do të mundësonte digjitalizimin e sistemit dhe komunikimin në mes të niveleve të ndryshme të shëndetësisë prandaj paraqitet nevoja e menjëhershme për hartimin e një dokumenti strategjik që do të shërbejë si udhërrëfyes e zhvillimit dhe funksionalizimit të plotë të sistemit të integruar të Informimit shëndetësor deri në vitin 2030.

3. METODOLOGJIA

Qeveria e Republikës së Kosovë ka përcaktuar digjitalizimin si një nga prioritetet kryesore të vendit, prandaj katër shtyllat e SKZH-së kanë identifikuar objektiva dhe tregues përmes të cilëve synohet të planifikohen intervenime konkrete në sektorë të ndryshëm.

Plani Strategjik do të shërbejë si udhërrëfyes politik dhe profesional në zhvillimin e sektorit të shëndetësisë që ka për qëllim zhvillimin e sistemit të Informimit shëndetësor 2024-2030.

Gjatë procesit të hartimit të Planit Strategjik janë përdorë metodat kuantitative dhe kualitative të hulumtimit të gjendjes aktuale në sektorin e shëndetësisë të nxjerra nga Studimi i fizibilitetit për sistemin e Informimit shëndetësor. Gjithashtu përvojat e zbatimit të Strategjisë së SISH 2011–2021, dokumentacioni relevant studimor vendor dhe ndërkombëtar për sistemin e Informimit, si dhe vlerësimi i ekspertëve, me rekomandimet të punëtorive dhe takimeve me ekipet dhe/ose menaxherët e institucioneve shëndetësore, vendor dhe ndërkombëtar.

Procesi i hartimit të planit strategjik për zhvillimin e sistemit të Informimit shëndetësor ka përdorë qasje sistematike të vlerësimit të aktiviteteve të administrimit dhe ndryshimit duke përdorur proceset dhe mjetet e përcaktuara gjatë vlerësimeve. Procesi është mbështetur me një komunikim efektiv midis palëve të interesuara dhe ekipeve duke krijuar, zhvilluar, shpërndarë dhe menaxhuar mesazhe dhe materiale komunikimi. Gjatë procesit të hartimit të dokumentit strategjik janë përfshirë edhe institucionet tjera relevante si Zyra për Planifikim strategjik e Qeverisë, Ministria e Financave dhe Transfereve, Agjencia e shoqërisë dhe Informimit dhe institucionet shëndetësore të të tri niveleve të kujdesit shëndetësor që do të jenë përgjegjëse për zbatimin dhe zhvillimin e sistemit të Informimit shëndetësor.

Të dhënat zyrtare për përgatitjen e analizave të sektorit gjatë studimit të fizibilitetit për SISH janë siguruar nga: ASK, MSh dhe IKShPK. Me qëllim të krahasimit të indikatorëve me vendet e Bashkimit Evropian dhe të Rajonit, studimi ka përdorur të dhënat nga vendet tjera. Gjatë hartimit të Strategjisë janë konsultuar edhe dokumente të tjera relevante si: Strategjia dhe Plani Kombëtar për zhvillim 2030, Programi për reforma ekonomike 2023-2025, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2023-2025, Plani Kombëtar për Zhvillim 2023-2025, Deklarata e Prioriteteve të Qeverisë 2023-2030 si dhe Marrëveshja e Stabilizim Asociimit e nënshkruar me Bashkimin Evropian.

Pas analizës të të dhënave në dispozicion, është përfshirë edhe analiza SWOT- (analiza e pikave të forta, pikave të dobëta, mundësive dhe rreziqeve të sistemit shëndetësor) e cila është zhvilluar nga anëtarët e grupit punues dhe janë nxjerrë përfundimet në bazë të të cilave është identifikuar objektiva strategjike dhe objektivat specifike për periudhën 2024-2030

4. SFONDI

Ministria e Shëndetësisë ka bërë përpjekje dhe investime të rëndësishme vitet e fundit në zhvillimin e sistemit të Informimit shëndetësor, por edhe përkundër këtyre përpjekjeve sistemi i Informimit shëndetësor (SISH) është shumë i fragmentuar, mungojnë të dhënat thelbësore për vendim marrje bazuar në dëshmi që është parakusht bazik për zhvillimin e një sistemi shëndetësor efektiv që ofron shërbime shëndetësore cilësore dhe të sigurta. Rezultat i SISH-it është informimi me kohë, me të dhëna valide dhe relevante për të gjithë pjesëmarrësit në sistemin shëndetësor. Mungesa e sistemit shëndetësor funksional dhe të integruar pamundëson një planifikim efektiv dhe alokim të drejtë të burimeve në dispozicion për të siguruar një performancë të duhur të institucioneve dhe të ofruesve të kujdesit shëndetësor. Në mungesë të sistemit të Informimit paraqiten vështirësi në llogaridhënie si pasojë e paqartësive të roleve dhe përgjegjësive të organizatave dhe individëve që reflektohen në mungesa serioze me furnizimin dhe distribuimin.

Përpjekjet e Ministrisë së Shëndetësisë për zhvillimin dhe funksionalizimin e sistemit të Informimit shëndetësor kanë filluar qysh në vitet 2002/2003 përmes të projektit të mbështetur nga Agjencioni Evropian për Rindërtim (AER) i cili është pilotuar në QKUK, në qendrat kryesore të mjekësisë familjare në Kosovë, IKSHPK, spitalin regjional të Gjakovës dhe spitalin regjional të Gjilanit. Duke u bazuar në rezultatet e këtij pilotimi, MSH ka zbatuar procedurat e grumbullimit të të dhënave në tërë vendin. Gjatë periudhës 2005 – 2006, Ministria e Shëndetësisë ka blerë Modulin e administrimit të burimeve njerëzore dhe ka trajnuar përafërsisht 80 zyrtarë nga të gjitha institucionet e shëndetit publik, në menaxhimin e burimeve njerëzore, mirëpo për shkak të mos mirëmbajtjes ky modul nuk ka funksionuar.

Në vitin 2009 përmes fondeve të Komisionit Evropian është zhvilluar projekti SWAP që ka përfshirë një studim gjithëpërfshirës të sistemit të Informimit shëndetësor. Mbi bazën e këtij studimi Ministria e Shëndetësisë ka miratuar Strategjinë e Sistemit të Informimit shëndetësor për një periudhë dhjetë vjeçare. Zbatimi i kësaj strategjie ishte përcaktuar që të financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe projekti i KSV/017 i financuar nga Qeveria e Luksemburgut. Edhe ky projekt nuk ka arritur të zbatohet dhe si i tillë është përfunduar në vitin 2018 pasi një rezolute të miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe raportit të Zyrës kombëtare të auditimit ku janë evidentuar parregullsi.


Përpjekjet për të krijuar një zgjidhje të centralizuar “web-based” (BHIS) për institucionet e kujdesit shëndetësor parësor, nga Ministria e Shëndetësisë me burimet e veta të kufizuara është treguar si përpjekje e qëlluar, pasi që në 29 Qendrat Familjare Mjekësore Kryesore dhe shumica e Qendrave Kryesore Familjare, aktualisht po e përdorin sistemin. Kjo sugjeron që ofruesit e kujdesit shëndetësor po e shohin të dobishëm sistemin BHIS dhe po mbështeten në të më shumë për të menaxhuar kujdesin ndaj pacientit dhe të dhënat mjekësore.

Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë të zhvilluara sisteme funksionale të Informimit shëndetësor dhe aktualisht janë në proces të digjitalizimit të mëtutjeshëm të sistemeve shëndetësore. Kosova aktualisht është vendi i vetëm në Ballkanin perëndimor që ende nuk ka arritur të funksionalizoj një sistem të integruar të Informimit shëndetësor. Programi Evropian – Iniciativa e Ballkanit Perëndimor "Veprimi i Bashkuar për Shëndet më të Mirë" përfshin gjithashtu transformimin shëndetësor digjital 2021-2025 të Ballkanit Perëndimor për t'u përshtetur fokusin në mbështetjen e menaxhimit të shëndetit të pacientëve dhe popullatës dhe telemjekësisë në sistemet shëndetësore. Ky program synon të vendet e Ballkanit Perëndimor të krijojnë platforma për të vlerësuar pjekurinë digjitale dhe gatishmërinë digjitale, për të rritur shkrim-leximin digjital tek profesionistët e kujdesit shëndetësor dhe popullata, zhvillimin e "Elektroni Health Rekord (EHR)" për të shërbyer si një katalizator për punën multidisiplinare, mbështetjen e vendimeve për sëmundjet jo ngjitëse, menaxhimin e shëndetit të popullatës me ndërfaqe specifike për mënjanimin e rrezikut dhe telemjekësia dhe zgjidhjet e tjera digjitale në mënyrë të përshtatshme me EHR- në. Për këtë qëllim Kosova duhet që të ndjekë këtë proces me vendet tjera të Ballkanit perëndimor në mënyrë që të jetë pjesë e proceseve digjitale në shëndetësi.

4.1. Sistemi i Informimit shëndetësor bazik

Studimi i fizibilitetit për sistemin e Informimit shëndetësor i zhvilluar në vitin 2023 në Kosovë vë në pah nevojën për vazhdimin e BHIS i cili do të rrisë më tej aftësitë e sistemit dhe do të sigurojë suksesin e tij të vazhdueshëm në përmirësimin e rezultateve të kujdesit shëndetësor. Shpërndarja gjeografike e regjistrimit fillestar të pacientëve në BHIS është një tregues i rëndësishëm i shtrirjes dhe ndikimit të sistemit në institucionet e kujdesit shëndetësor në Kosovë. Duke analizuar shpërndarjen e regjistrimeve fillestare të pacientëve, mund të dallohet se ku përdoret më gjerësisht sistemi BHIS dhe ku mund të ketë nevojë për më shumë mbështetje ose burime. Për më tepër, analizimi i shpërndarjes gjeografike të regjistrimit fillestar të pacientëve në BHIS mund të ndihmojë ofruesit e kujdesit shëndetësor dhe politike bërësit të identifikojnë fushat që mund të kërkojnë burime ose mbështetje shtesë për të përmirësuar rezultatet e kujdesit shëndetësor. Për shembull, rajonet me fluska më të vogla mund të kenë nevojë për më shumë shtrirje dhe edukim rreth sistemit BHIS për të inkurajuar më shumë pacientë që të regjistrohen dhe përdorin atë, ndërsa rajonet me fluska më të mëdha mund të kenë nevojë për më shumë burime për të menaxhuar vëllimin e rritur të të dhënave dhe vizitave të pacientëve.

Çështjet më të rëndësishme që lidhen me BHIS në funksionimin e tij aktual janë theksuar përmes diskutimeve me përdoruesit dhe ekspertët nga kompanitë partnere që kanë ndërtuar dhe/ose mirëmbajtur sistemin, si dhe nëpërmjet komenteve të përdoruesve të mbledhura nëpërmjet anketave në internet. Ato lidhen me infrastrukturën e TIK-ut, konkretisht 1) kryesisht mosdisponueshmërinë ose ndërprerjet e rrjetit (lidhjet e brendshme dhe të internetit), 2) numrin dhe besueshmërinë e printerëve, si dhe 3) disponueshmërinë e tonerëve, të cilat në detale janë përshkruar në studimin e fizibilitetit për SISH.



Ndërsa më shumë të dhëna si të dhënat e popullsisë, zona e mbulimit të objektit dhe trajnimi i përdoruesve fundorë do të kishin qenë të dobishme për të bërë një analizë më të saktë të përdorimit të BHS nga institucionet shëndetësore, të dhënat e paraqitura në këtë vlerësim të shpejtë janë ende tregues të fortë të rritjes së përdorimit aktual. Rritja e numrit të pacientëve të regjistruar në sistem dhe rritja e numrit të vizitave të regjistruara ndër vite tregojnë një tendencë pozitive drejt përdorimit të sistemit BHS.

Prandaj, ndërsa më shumë të dhëna do të ishin të dobishme për të pasur një analizë më të saktë të përdorimit të BHS, të dhënat e disponueshme ende ofrojnë njohuri të vlefshme për gjendjen aktuale të sistemit dhe sugjerojnë se ka potencial për rritje të mëtejshme dhe adoptim të sistemit në të ardhmen.

Fakti që gjithsej 904,270 persona që morën të paktën një dozë vaksine u regjistruan në modulën e vaksinimit BHIS dhe gjithsej u regjistruan 1,836,002 vaksina, është një tregues i fortë i aftësive teknike të sistemit BHIS dhe aftësisë së tij për të trajtuar vëllime të mëdha të dhënash.

Zbatimi dhe përdorimi i suksesshëm i modulit të vaksinimit në BHIS nxjerr në pah besueshmërinë dhe efikasitetin e sistemit. Pavarësisht disa problemeve teknike si problemet e rrjetit, lidhjes me internetin dhe problemet e printerave, sistemi BHIS ishte në gjendje të mbështeste një numër të madh përdoruesish dhe të regjistronte në mënyrë efektive të dhënat e vaksinimit.

Zbatimi i suksesshëm i modulit të vaksinimit BHIS mund t'i atribuohet zgjidhjes teknike të sistemit dhe aftësisë së tij për të trajtuar vëllime të mëdha të dhënash. Është një dëshmi e shkallëzueshmërisë dhe aftësisë së sistemit për të mbështetur një vëllim të madh përdoruesish edhe në rrethana sfiduese.

Për më tepër, mungesa e mirëmbajtjes dhe mbështetjes për disa vite ka rezultuar që sistemi të mos ketë veçori të reja dhe të mos rregullojë të gjitha gabimet, të cilat mund të ndikojnë në kënaqësinë e përdoruesit. Vlerësimi tregon gjithashtu se disa përdorues nuk po e përdorin sistemin pavarësisht disponueshmërisë së tij, duke theksuar nevojën për trajnim dhe promovim më të mirë të përdoruesve për të rritur adoptimin e tyre. Në përgjithësi, zbatimi i suksesshëm i modulit të vaksinimit BHIS demonstroi kapacitetet teknike të sistemit dhe aftësinë e tij për të mbështetur proceset kritike të kujdesit shëndetësor si vaksinimi.

4.2. Sistemet e mbartura (Legacy)

Të ashtuquajturat sisteme/ module të mbartura përfshijnë sistemet e mëposhtme:

- Sistemi për menaxhimin e stokut farmaceutik
- Burimet njerëzore
- Punëtoreve shëndetësor
- Moduli i specialistëve
- Licencimi i institucioneve shëndetësore

Të gjitha sistemet janë zhvilluar si aplikacion ueb në stack teknologji Microsoft (#C, ASP.NET MVC5, Net Framework 4.6.1, MS SQL Server, Microsoft Report Builder në format RDL, etj). Aplikacioni ndjek një arkitekturë me tre nivele, e cila e ndan aplikacionin

në tre shtresa të dallueshme: shtresa e prezantimit, logjika e biznesit dhe qasja e të dhënave të cilat ndodhen brenda së njëjtës zgjidhje dhe hostohen në serverin e aplikacionit.

4.3. Sistemi Informimit i transfuzionit të gjakut

Sistemi Informimit transfuzionit është në përdorim në QTKTK - Prishtinë që nga viti 2005 dhe plotëson shumicën e kërkesave të NCBTK-së. Është planifikuar të zbatohet sistemi në qendrat rajonale të transfuzionit në vitin 2024.

Ajo që mungon është monitorimi spitalor i informimit të gjurmimit të produkteve të gjakut kur ato arrijnë në objektet shëndetësore nga qendrat e transfuzionit, pra nuk ka informacion se ku dhe në cilin pacient janë përdorur.

Në terma afatshkurtër, sistemi duhet të përmirësohet duke lidhur qendrat rajonale të transfuzionit dhe në terma afatgjatë, zbatimi i sistemit të INFORMIMIT spitalor duhet të përfshijë monitorimin e gjurmimit të procedurave të transfuzionit tek pacienti.

4.4. Sistemi i Informimit i Fondit të sigurimit shëndetësor

HIF ka investuar në mënyrë të konsiderueshme në zhvillimin e Sistemit të informimit HIF (HIFIS). Sistemi është testuar dhe rreth 1.000 përdorues janë trajnuar për ta përdorur atë. Sistemi ofron funksione bazë për mirëmbajtjen e regjistrit të përfituesve, mbledhjen e të ardhurave (përfshirë mjetin online për pagesat individuale premium) dhe pagesat e shërbimit. Lidhja me sistemet e jashtme automatizohet për regjistrin civil, skemën e kategorive të përjashtuara, administratën tatimore dhe bankat. Sistemi bazohet në arkitekturën dhe teknologjinë solide, të testuar mirë, por duke marrë parasysh HIF ende nuk po menaxhon paketat dhe shërbimet e blerjes, sistemi nuk është në përdorim të plotë. Ajo ende duhet të arrijë përdorimin e saj të pjekur që do të zbulojë kërkesa shtesë funksionale, teknike dhe fine-akordim. Prandaj, ndihma teknike për reformën e sigurimeve shëndetësore mund të përballet me nevojën për mbështetje shtesë për zbatimin e HIFIS.

Sistemi përbëhet nga këto module: Financa dhe kontabiliteti, regjistri i anëtarëve, regjistri i skemave sociale, mbledhja e primeve nga bizneset, primet individuale, institucionet shëndetësore, farmacitë, regjistri i farmacistëve, barnat dhe shërbimet shëndetësore, E-përshkrimi, E-Pacienti, administrata, asetet.

Nëpërmjet këtyre moduleve mundësohet administrimi dhe administrimi i financave të fondit; informacion rreth numrit të përfituesve të siguruar; sigurohen të dhëna nga skemat sociale, të cilat sipas ligjit janë përfituese të sigurimeve shëndetësore; Mundësohet raportimi dhe mbledhja e primeve nga bizneset; lëshimin e urdhrave të pagesës për të gjithë shtetasit që nuk kanë statusin e "siguruar" dhe dëshirojnë të jenë vullnetarisht pjesë e të siguruarit; mundësohet kontraktimi i farmacive dhe lejohet ofrimi i shërbimeve nëpërmjet E-përshkrimi; ofrohet shërbimi i përcaktimit të përqindjes së rimbursimit nga Fondi për barnat dhe shërbimet shëndetësore; moduli mundëson qasjen e të gjitha farmacive të kontraktuara nga Fondi dhe sigurimin e medikamenteve për pacientët

sipas listës së përcaktuar të rimbursimit. Mundësohet dhënia e informimit për pacientin lidhur me statusin e fondit të sigurimit shëndetësor dhe qasjen në historikun e shërbimeve dhe ilaçeve të marra; Nëpërmjet këtij moduli mundësohet regjistrimi, amortizimi, rivlerësimi dhe tjetërsimi i pasurive. Gjithashtu, identifikimi bëhet me një kod unik (barcode) për të gjitha pasuritë që janë të regjistruara; Mundësohet raportimi i problemeve në sistem nga përdoruesit përfundimtarë dhe trajtimi i tyre nga administratori i sistemit. Gjithashtu, nëpërmjet këtij moduli, përdoruesit fundorë kanë mundësi të vlerësojnë problemin e trajtuar nga administratorët e sistemit.

Sistemi i informimit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore (SIFSSH) u zhvillua nga një kompani lokale (DataProgNet) Edhe pse SIFSSH është zbatuar, testuar dhe pranuar, sistemi nuk është ende plotësisht operacional sepse SIF nuk funksionon ende plotësisht si një fond sigurimi, pra, ai ende nuk ka filluar mbledhjen e primeve/ kontributeve nga bizneset dhe individët dhe pagimin/rimbursimin e ofruesve lokalë të kujdesit shëndetësor. I vetmi proces biznesi që SIF mbështet aktualisht është trajtimi jashtë vendit.

Një vlerësim i saktë i SIFSSH të zbatuar kërkon që SIF të përmbushë rolin e saj statutor në financimin e sistemit të kujdesit shëndetësor për të siguruar performancën dhe cilësinë e SIFSSH. Megjithatë, diskutimet dhe paraqitja e sistemit duket se tregojnë se shitësi po jep një sistem solid bazuar në teknologjinë aktuale, aftësitë e mira të integritetit dhe standardet e sigurisë së të dhënave. Rreziqet kryesore të perceptuara deri tani të zbuluara janë mungesa e stafit të TIK-ut në Fond, dhe nën kapacitetin e Fondit si organizatë, praktikë operationale dhe përvojë e proceseve të biznesit të sigurimeve shëndetësore dhe mbështetje it në operationet e përditshme, sepse sistemi është ende në fazën e para-prodhimit.

4.5. Sistemet e- shëndetësia që aktualisht nuk janë zhvilluar

4.5.1. Sistemi i Informimit Spitalor (SIS)

Spitalet në Kosovë nuk përdorin ndonjë SIS gjithëpërfshirës, vetëm disa pjesë të BHIS për mbajtjen e të dhënave mjekësore të pacientëve ambulatorë. Ndërtimi i EHR në nivel kombëtar është pika kyçe strategjike për shëndetin elektronik në Kosovë, dhe kjo nuk mund të bëhet pa funksionimin dhe funksionimin e tij në të gjitha spitalet. Gjithashtu, spitalet janë të sistemeve të mëdha (numri i punonjësve, kostot operative, kompleksiteti i proceseve, pajisjet e sofistikuar) për t'u menaxhuar pa sistem gjithëpërfshirës SIS që do t'i ndihmojë ata të jenë më efikas.

4.5.2. Sistemi i Informimit Laboratorik (SIL)

Sistemi i informimit Laboratorik (SIL) është një aplikacion qëllimi kryesor i të cilit është të automatizojë proceset në laboratorët klinikë. Është ndërtuar rreth një baze të dhënash të centralizuar të mostrave dhe çdo meta të dhënash, rezultatesh, rrjedhash pune dhe instrumentesh që lidhen me to. Kjo jo vetëm që lejon një laborator të mbetet i organizuar, por gjithashtu lehtëson efikasitetin, transparencën dhe pajtueshmërinë. Studimi rekomandon zbatimin e sistemit SIL në të gjitha institucionet publike të kujdesit shëndetësor që kanë laborator klinik dhe ta integrojnë atë me BHIS/HIS në mënyrë që ato të mund të veprojnë si një sistem i plotë EMR i institucionit. Përpara se ta integrojnë atë, SIL mund të funksionojë si një zgjidhje e pavarur që i shërben vetëm departamentit të laboratorit.

4.5.3. Sistemi kompjuterik i arkivit të radiografisë imazherike (PACS)

Një PACS është një teknologji e imazhit mjekësor që përdoret për të ruajtur, menaxhuar dhe shpërndarë imazhe mjekësore digjitale, të tilla si rrezet X, skanimet CT, MRI dhe imazhet me ultratinguj. Kjo teknologji zëvendëson sistemet tradicionale të bazuara në film që kërkojnë kohë dhe të kushtueshme dhe shpesh kërkojnë transport fizik të imazheve midis vendndodhjeve të ndryshme. PACS nuk kufizohet vetëm në radiologji, pasi përdoret edhe në specialitete të tjera mjekësore që përdorin imazhe mjekësore, si kardiologjia, patologjia dhe dermatologjia. Sistemet PACS mund të personalizohen për të përmbushur nevojat specifike të specialiteteve të ndryshme mjekësore dhe mund të integrohen me sisteme të tjera informacioni të kujdesit shëndetësor, të tilla si Regjistrimet Elektronike të Shëndetit (EHR) dhe Sistemet e INFORMIMIT të Radiologjisë (RIS), për të ofruar një zgjidhje gjithëpërfshirëse për menaxhimin e imazheve mjekësore. të dhëna.

4.5.4. Sistemi i Informimit Radiologjik (RIS)

Sistemi INFORMIMIT i Radiologjisë (RIS) është një softuer që është krijuar për të menaxhuar dhe automatizuar rrjedhën e punës dhe të dhënat e lidhura me departamentet e radiologjisë në objektet e kujdesit shëndetësor. Objektivi i tij kryesor është të menaxhojë të dhënat e pacientit, procedurat e imazherisë dhe shpërndarjen e raporteve dhe imazheve diagnostike tek profesionistët e kujdesit shëndetësor. RIS zakonisht integrohet me sisteme të tjera informacioni të kujdesit shëndetësor, të tilla si Regjistrimet Elektronike të Shëndetit (EHR) dhe Sistemet e Arkivimit dhe Komunikimit të fotografive (PACS), për të ofruar një zgjidhje gjithëpërfshirëse për menaxhimin e të dhënave të imazhit mjekësor.

4.5.5. Numri mesatar i kompjuterëve-ve për punonjës

Numri i kompjuterëve për punonjës në një spital të përgjithshëm mund të ndryshojë në varësi të një numri faktorësh, duke përfshirë madhësinë e spitalit, departamentin ose rolin e punonjësit dhe buxhetin e spitalit për teknologjinë.

Në Bashkimin Evropian, spitalet më të mëdha përgjithësisht priren të kenë një raport më të lartë të kompjuterëve ndaj punonjësve, shpesh duke i siguruar secilit punonjës kompjuterin e tij për mbajtjen e regjistrave dhe komunikimin efikas. Kjo mund të variojë nga një kompjuter për dy deri në tre punonjës në spitalet më të vogla në një kompjuter për çdo punonjës në spitalet më të mëdha.

Vlen gjithashtu të theksohet se disa punonjës të spitalit mund të kenë nevojë për qasje në pajisje të specializuara, të tilla si stacione pune për imazhe mjekësore ose kompjuterë kërkimi, përveç kompjuterit të tyre të zakonshëm të zyrës.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri mesatar i kompjuterëve për punonjës në spitalin e përgjithshëm në Kosovë, bazuar në të dhënat e intervistave të mbledhura në mars 2023.

Spitalet e përgjithshme	Të punësuarit	Shtretërit	Kompjuter	Stafi TI	Kompjuter	Kompjuter/ punonjës
SP. Ferizaj	300	90	80	1	0,89	0,27
SP. Gjakovë	560	419	120	1	0,29	0,21
SP. Gjilan	550	360	200	2	0,56	0,36
SP. Mitrovicë	417	183	120	1	0,66	0,29
SP. Pejë	576	400	135	2	0,34	0,23
SP. Prizren	730	550	220	2	0,40	0,30
TOTAL	3133	2002	875	9	0,44	0,28

Tabela 1. Numri i kompjuterëve për të punësuar

4.6. Mungesa e kuadrit të teknologjisë së informacionit

Spektori i kujdesit shëndetësor në Kosovë po përballë me një sfidë serioze për shkak të mungesës së profesionistëve të TI-së. Profesionistët e TI-së janë thelbësorë për transformimin digjital të shërbimeve të kujdesit shëndetësor, të cilat mund të përmirësojnë cilësinë, efikasitetin dhe qasjen e ofrimit të kujdesit shëndetësor. Arsye për këtë mungesë përfshijnë ritmin e shpejtë të ndryshimit teknologjik, kërkesën e lartë për aftësitë e IT në sektorë të ndryshëm në Evropë dhe jashtë saj, rritja e "ikjes së trurit të TIK",

atraktiviteti i ulët i karrierave të IT për të rinjtë dhe gratë në sektorin publik, jo- Nivelet dhe modelet konkurruese të listave të pagave në institucionet shëndetësore publike për profesionistët e TIK-ut dhe furnizimi i pamjaftueshëm i arsimit dhe trajnimit në IT.

Mungesa e profesionistëve të TI-së në sektorin e kujdesit shëndetësor është një sfidë e zakonshme me të cilën përballën shumë vende dhe mund të ketë implikime të rëndësishme për cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor. Investimi në tërheqjen, mbajtjen dhe përmirësimin e profesionistëve të TI-së është thelbësor për arritjen e transformimit digjital në kujdesin shëndetësor, i cili mund të përmirësojë rezultatet e pacientëve dhe të ulë kostot. Për më tepër, nxitja e bashkëpunimit dhe inovacionit midis aktorëve të ndryshëm mund të ndihmojë në krijimin e një mjedisi më mbështetës për zhvillimin dhe zbatimin e teknologjive të reja në kujdesin shëndetësor. Në përgjithësi, adresimi i mungesës së profesionistëve të TI-së në sektorin e kujdesit shëndetësor kërkon një qasje të shumanshme që përfshin bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet aktorëve të ndryshëm, duke përfshirë qeverinë, sektorin privat dhe institucionet arsimore. Vlerësimi aktual tregoi një numër të kufizuar në të gjitha institucionet kryesore të interesit, si dhe në kujdesin shëndetësor parësor dhe spitalet publike. Vetëm QKUK ka një numër më të madh të kuadrit të TI-së. Pikërisht si pikë referimi për numrin e stafit të TIK-ut në sektorin shëndetësor, bazuar në të dhënat e Cedefop (Qendra Evropiane për Zhvillimin e Trajnimit Profesional) në vitin 2020 në shtetet anëtare të BE-së, nga të gjithë të punësuarit në sektorin e “shëndetësisë dhe kujdesit social”. ka qenë 0,5% punonjës në kategoritë profesionistë të TIK-ut. 2(0,33%) dhe teknikë TIK. 3(0,17%), por është një rritje e madhe në lidhje me të dhënat e vitit 2015, kur ka pasur vetëm 0,1% të profesionistëve të TIK-ut dhe vetëm 0,06% të teknikëve të TIK-ut në sektorin e "shëndetit dhe kujdesit social".⁴

Institucioni	Stafi i TIK-ut
MSH	5 (duhet të jetë 24 nga grafiku organizativ i miratuar)
QKUK	20 (8 profesionistë TIK + 12 teknikë TIK)
IKSHPK	3 (në zyrën qendrore)
QKKTGJ	1
FSSh	1
AKPPM	1
SPITALET	1.5

Tabela II. Numri i të punësuarve me IT

4.7. Korniza ligjore për zbatimin dhe zhvillimin e SISH

Ligji bazik për shëndetësi ka rregulluar pjesërisht sistemin unik dhe të integruar të Informimit shëndetësor, me të cilin ka përcaktuar që Ministria siguron themelimin, zhvillimin dhe funksionimin e sistemit unik dhe të integruar të Informimit shëndetësor në gjithë sektorin e shëndetësisë, pavarësisht nga forma e pronësisë, lloji i institucionit dhe organizimi i tij, të bazuar në normativa dhe standard të përcaktuara nga Ministria. Përgjegjëse për financimin dhe funksionimin operativ të SISH është Ministria.

Udhëzimi administrativ nr. 11/2013 Sistemi informimit shëndetësor dhe raportimi i të dhënave statistikore shëndetësore ka përcaktuar mënyrën e funksionimit të sistemit të informatave shëndetësore si dhe raportimit të të dhënave statistikore të mbledhura me këtë sistem në funksion të planifikimit adekuat, programit dhe menaxhimit kualitativ, të shpejtë dhe efikas të shërbimeve shëndetësore. Ky Udhëzim administrativ pjesërisht është zbatuar dhe i njëjti për shkak të politikës jo të qartë të sistemit të Informimit shëndetësor nuk ka arritur të plotësohet dhe ndryshohet që nga viti 2013. Sipas studimit të fizibilitetit për SISH është konstatuar që sistemi ligjor i Kosovës nuk adreson dhe nuk rregullon kërkesat themelore dhe minimale për ndërtimin e një sistemi informimit shëndetësor, nuk është adekuat dhe nuk e rregullon një sistem të mirëfilltë të INFORMIMIT shëndetësor. Po ashtu, mungon një baze të qartë ligjore për projekte të tilla, duke përfshirë vendosjen e detyrimeve për qëllime të futjes së të dhënave ose ndarjes së të dhënave me subjekte dhe institucione të tjera. Ministria planifikon që në Ligjin e ri të shëndetësisë të përfshijë një kapitull të veçantë Sistemin e Informimit shëndetësor, ku do të përcaktohen qartë, Rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha institucioneve shëndetësore dhe akterëve të përfshirë në nivel vendi, përcaktimi i ruajtjes të të dhënave në përputhje me standardet ndërkombëtare respektivisht legjislationin e BE-së, aspektet tjera ndërinstitutionale; gjobat dhe kundërvajtjet e personave fizik, personave juridik, personave përgjegjës të institucioneve shëndetësore.

4.8. Rreziqet dhe ndikimet

Sa i përket rreziqeve dhe ndikimeve në zbatimin e zhvillimit të sistemit të Informimit shëndetësor fokusi duhet të vendoset në plotësimin dhe ndryshimin e kornizës ligjore. Zbatimi i ligjit për sigurimin shëndetësor mund të ketë ndikim të madh në HIFIS. Zbatimi i ligjit të sigurimit shëndetësor mund të ketë ndikim të madh në SISH kur modeli i financimit të institucioneve shëndetësore do të ndryshojë dhe institucionet shëndetësore duhet të lëshojnë faturën (kërkesat e sigurimit shëndetësor) për shërbimet e tyre. Mungesa e profesionistëve të TI-së mund të ndikojë seriozisht në planet e zhvillimit të shëndetit elektronik. Mungesa dhe besueshmëria e infrastrukturës së TIK-ut në PHF mund të ndikojë seriozisht në planin për të zbatuar BHIS me kapacitet të plotë.

Plani gjithashtu paraqet rreziqe dhe sfida të mundshme, duke përfshirë nevojën për buxhete dhe burime adekuate që mund të shkaktojnë vonesa në zbatim. Numri i madh i projekteve të ndërvarura kërkon aftësi kompetente të menaxhimit të projektit dhe personel shtesë.

Përvoja nga vendet e tjera tregon se projekte të tilla mund të zgjasin më shumë se pesë vjet. Megjithatë, me buxhete dhe burime të mjaftueshme të siguruara për zbatim dhe prokurim publik efikas, sistemet mund të kompletohen brenda kornizës kohore të propozuar.

Plani gjithashtu kërkon kuadër shtesë, veçanërisht për rolin e Menaxherit të Projektit, në DSIS (Departamenti i Sistemit informimit Shëndetësor të MSH). Megjithëse këto aktivitete janë të përfshira në plan, është thelbësore që ato të fillojnë sa më shpejt që të jetë e mundur për të rritur kapacitetin.

Për të mbajtur ritmin me përparimet teknologjike, ndryshimin e standardeve të industrisë dhe sfidat e shfaqura në eHealth, nevojitet ruajtjen e një kornize të fuqishme dhe efektive për sigurimin e cilësisë dhe besueshmërisë së zgjidhjeve softuerike të eHealth në Kosovë.

Në përgjithësi, është e rëndësishme të merren parasysh me kujdes këto rreziqe dhe sfida të mundshme, si dhe përfitimet e mundshme të planit, për të marrë vendime të informuara për zbatimin e tij dhe prioritetet në zbatim. Një strategji e detajuar dhe e planifikuar mirë, duke përfshirë angazhimin e palëve të interesuara dhe menaxhimin e rrezikut, do të jetë thelbësore për suksesin e këtyre projekteve.

Sfidat e migrimit të të dhënave nga BHIS aktual në zgjidhjen e re mund të përbëjë vështirësi të rëndësishme. Nuk ka asnjë garanci se të gjitha të dhënat do të migrohen në mënyrë korrekte, duke çuar potencialisht në humbjen e të dhënave ose korrupsionin, gjë që mund të ndikojë negativisht në kujdesin ndaj pacientëve dhe proceset administrative. Zbatimi mund të has në rezistencën e ofruesit privat (në veçanti ofruesit e mëdhenj dhe të pjekur) për të përdorur BHIS si zgjidhje të bazuar në ueb pa integrimin me sistemet e tyre aktuale të informacionit.

4.9.Roli dhe mbështetja e partnerëve dhe e shoqërisë civile

Qëllimi i përgjithshëm i angazhimit të palëve të interesuara është që të nxisë drejtimin strategjik të zhvillimit të sistemit të Informimit shëndetësor dhe përsosmërinë operationale dhe të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm, nga i cili mund të përfitojnë organizatat, palët e tyre të interesit dhe shoqëria e gjerë.

Pritjet rreth zhvillimit të sistemit të Informimit shëndetësor mund të jenë të ndryshme për palët dhe grupet e interesit në krahasim me palët e interesuara organizative dhe institucionale. Palët e interesuara duhet të identifikohen në fillim të projekteve të ndryshimit. Pritjet e tyre në lidhje me përfitimet dhe afatet kohore duhet të parashikohen, konstatohen dhe menaxhohen që në fillim për të shmangur keqkuptimet dhe/ose zhgënjimet. Projektet e suksesshme të zbatimit duhet të kenë procese dhe qasje të strukturuar për të përfshirë dhe përfshirë grupet kryesore të përdoruesve të fundit klinikë.

Hapi i parë në zbatim të planit strategjik për SISH është identifikimi i palëve të interesuara dhe angazhimi gjatë fillimit të projektit. Edhe pse e vetëkuptueshme, shumë projekte ose e neglizhojnë këtë ose kufizojnë vëmendjen që i kushtohet edhe palëve më të dukshme të interesit. Kornizat për kategorizim mund të ndryshojnë sipas projektit, por shpesh përfshijnë: palët e brendshme të interesit, palët e jashtme të interesuara dhe

partnerët kryesorë ku shoqëria civile dhe mediat luajnë një rol shumë të rëndësishëm përmes qasjes pro aktive kritike si dhe informimi i qytetareve rreth pritshmërisë.

Aftësia për të dhënë mesazhin e duhur, nga personi i duhur, përmes kanalit të duhur, tek audienca e duhur, në kohën e duhur është shumë e rëndësishme. Komunikimet do të shërbejnë për të informuar palët e ndryshme të interesit dhe për të nxitur përgjigjet dhe/ose veprimet e duhura. Qasjet e synuara ndaj komunikimit përcaktohen në përgjigje të analizës së palëve të interesuara. Udhëheqësit dhe zbatuesit e ndryshimit në planin strategjik për zhvillimin e Sistemit të Informimit shëndetësor duhet të kuptojnë rolet e tyre përkatëse në komunikimin me një gamë të gjerë palësh të interesuara.

Plani strategjik për zhvillimin e sistemit të Informimit shëndetësor 2024-2030, qëllim kryesor të komunikimit gjatë të gjitha fazave të zbatimit do të ju ofrojë njerëzve atë që duhet të dinë për të bërë zgjedhje të informuara nëse/si duhet të pajtohen ose të angazhohen për iniciativën, ndërtimin e besimit me komunikim të sqartë për nevojën për ndryshim dhe vështirësinë e ndryshimit, duke përfshirë pasojat e mos ndryshimit dhe raportimin objektiv të progresit – ose mungesën e progresit – në mënyrë që njerëzit të mund të jenë kontribuues të përgjegjshëm për suksesin. Komponentët thelbësorë minimalë të komunikimit që plani strategjik do të synojë gjatë zbatimit është përcaktimi i audiencës së synuar, dhënia e informimit frekuenca dhe përgjegjësia për dhënie të informimit dhe formati i kërkuar.

5. OBJEKTIVAT

Plani strategjik për zhvillimin e sistemit të Informimit shëndetësor 2024-2030 përcakton një objektivë strategjike, “ **Zhvillimi i Sistemit të Informimit Shëndetësor**” që paraqet synimin e përgjithshëm dhe afatgjatë të Republikës së Kosovës për të zbatuar agjendën digjitale të Kosovës në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2030. Plani strategjik për zhvillimin e Sistemit të Informimit shëndetësor 2024-2030 është pjesë integrale e Strategjisë Sektoriale Shëndetësore 2023-2030, respektivisht në kuadër të Objektivës specifike “ Sistemi i Informimit shëndetësor (SISH) funksional dhe i integruar “Studimi i fizibilitetit për Sistemin e Informimit shëndetësor 2023, vëmendje e veçante rekomandon që duhet t’i kushtohet investimit në zhvillimin e mëtejshëm të sistemit kombëtar eHealth në Kosovë. Ministria e Shëndetësisë duhet të rishikojë statusin aktual të zhvillimeve të eHealth në Kosovë, për të qenë në gjendje të ri mendoje qasjen dhe të vendosë për arkitekturën kombëtare të shëndetit digjital dhe planet për zhvillimin e ardhshëm. Për të arritur objektiven strategjike, Plani strategjik për zhvillimin e Sistemit të Informimit shëndetësor 2024-2030, ka paraparë edhe synime specifike afatshkurtër dhe konkrete të paraqitura në kuadër të objektivave specifike. Këto objektiva specifike japin udhëzime dhe demonstrojnë mënyrat se si mund të arrihet objektiva strategjike.

5.1.OBJEKTIVA STRATEGJIKE I: Zhvillimi i Sistemit të Informimit Shëndetësor”

Me një vendim strategjik të qeverisë për të investuar në një sistem kombëtar e- Shëndetësia , Kosova mund të bëjë hapa të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore për qytetarët e saj në periudhën afatmesme nga viti 2024 deri në vitin 2030. Edhe pse ky synim është ambicioz, ai është i arritshëm me parakushtet që duhet të sigurohen bazuar në studimin e fizibilitetit që do të jetë pjesë integrali e këtij plani strategjik.

5.1.1. Objektiva specifike I Zhvillimi i qeverisjes dhe administrimit

Në kuadër të objektivit specifik *Zhvillimi i qeverisjes dhe administrimit* parashihen proceset e përgjithshme të menaxhimit dhe vendimmarrjes që sigurojnë përdorimin efektiv dhe të përgjegjshëm të sistemit të informimit shëndetësor. Kjo kërkon zhvillimin e strukturave të qarta qeverisëse dhe mekanizmeve të llogaridhënies për të mbikëqyrur zbatimin, funksionimin dhe menaxhimin e sistemit të Informimit shëndetësor. Qeverisja gjithashtu siguron mbikëqyrje të iniciativave digjitale në shëndetësi, duke përfshirë monitorimin e pajtueshmërisë, vlerësimin e rezultateve dhe *sigurimin e përdorimit etik të të dhënave shëndetësore*. Qeverisja përmirëson shërbimet dhe aplikacionet që mbështesin Ministrinë e Shëndetësisë me theks Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik (IKSHP) dhe palë të tjera të interesuara. Një infrastrukturë e centralizuar e qeverisjes dhe administrimit ofron një kornizë për menaxhimin e sistemeve mbështetëse në nivel kombëtar dhe praktika të standardizuara të menaxhimit të të dhënave, përfshirë politikat e qeverisjes së të dhënave dhe masat e sigurisë. Kjo qasje e centralizuar siguron qëndrueshmëri, siguri dhe pajtueshmëri me rregulloret dhe standardet në të gjithë sistemin e kujdesit shëndetësor. Qeverisja ka të bëjë me mekanizmat që përdoren për të udhëhequr, drejtuar ose rregulluar rrjedhën e një organizate ose sistemi. Qeverisja e fortë çon në vendime më të mira, përaftrim më të madh me prioritetet dhe më shumë pranim nga palët e interesuara.

Në lidhje me e shëndetësia, është e rëndësishme të krijohen marrëveshje formale për qeverisjen (dhe menaxhimin) e programeve të ndryshimit për të përcaktuar qartë rolet, përgjegjësitë dhe "kush bën çfarë?" përgjatë programit ose projektit. Struktura e qeverisjes identifikon mekanizmin me të cilin palët e interesuara mund të ndikojnë në prioritetet dhe progresin e një projekti. Adminsitrimi fokusohet në Masterin e menaxhimit të të dhënave dhe siguron që informacioni të mbetet vazhdimisht i besueshëm, i përditësuar dhe lehtësisht i qasshëm, duke fuqizuar përdoruesit.

5.1.2. **Objektiva specifike II** Zhvillimi i kapaciteteve administrative

Në kuadër të Objektivit Specifik II *Zhvillimi i kapaciteteve administrative* parasheh sigurimin e kërkesave organizative për ekzekutimin e suksesshëm të projekteve të e-shëndetësisë në Kosovë. Planit strategjik për zhvillimin e sistemit të Informimit shëndetësor, në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve administrative, parasheh themelimin e Organit drejtues të e shëndetësia, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e të gjitha projekteve digjitale në shëndetësi. Kjo përjashton modulet nga kategoria sistemet mbështetëse, sepse ato nuk janë pjesë e e-Shëndetësia, por më tepër softuer back-office i nevojshëm për funksionimin e projekteve të tjera, për të cilat institucionet përkatëse do të mbeten përgjegjës. Standardet dhe procedurat, një kuadër ligjor, proceset e menaxhimit të projekteve dhe produkteve dhe proceset e menaxhimit të ndryshimeve duhet të vendosen të gjitha. Krijimi i infrastrukturës së duhur harduerike (serverët, PC-të, rrjetet, printerët, etj.) është një tjetër mundësi kyçe për projektin e-shëndetësia.

Në kuadër të këtij objektivi specifik parashihet themelimi dhe zhvillimi i Qendrës së Inovacionit të Shëndetit Digjital, zhvillimi i qendrës së sofistikuar të thirrjeve për sektorin shëndetësor që është thelbësor për shfrytëzimin më të mirë të stafit shëndetësor. Ai ofron shërbime të tilla si caktimi i takimeve, rimbushjet e recetave dhe pyetje të përgjithshme. Ai gjithashtu do të mbështesë qytetarët në situata krize siç është pandemia e COVID-19 dhe do t'u mundësojë profesionistëve shëndetësorë të menaxhojnë këto lloj situatash me skripta, udhëzime, trajnime të paracaktuara etj., duke mundësuar efikasitet dhe komunikim më të mirë mes qytetarëve dhe sektorit shëndetësor.

5.1.3. **Objektiva specifike III** Zhvillimi i sistemeve mbështetëse

Në kuadër të Objektivit Specifik III Zhvillimi i sistemeve mbështetëse, parashihet që modulet ekzistuese, duke përfshirë Modulin e profesionisteve shëndetësorë, licencimin e institucioneve private shëndetësore, modulin e menaxhimit të stokut farmaceutik dhe modulet tjera janë zhvilluar për të plotësuar nevojat specifike dhe punët operacionale të Ministrisë së Shëndetësisë dhe institucioneve të ndryshme shëndetësore. Këto sisteme janë zbatuar në një gamë të gjerë të strukturave të kujdesit shëndetësor dhe përdoren aktivisht nga përdoruesit në aktivitetet e tyre të përditshme të punës. Planit strategjik parasheh investimin në të gjitha sistemet Legacy, së bashku me përmirësimet e moduleve, përmirësimet funksionale dhe përmirësimet e infrastrukturës. Për të siguruar performancën optimale të përdoruesit, është thelbësore të prioritetizohet përmirësimi i moduleve ekzistuese bazuar në feedback-un e përdoruesve dhe zgjidhjen e "bugs" të raportuara. Trajtimi i këtyre çështjeve do të kontribuojë në përmirësimin e përvojës së përdoruesit dhe do të përmirësojë efikasitetin e rrjedhës së punës. Planit strategjik përmes aktiviteteve do të mundësojë ndërlidhjen e sistemeve Legacy në të gjitha institucionet dhe njësitë shëndetësore për të arritur një mbulim tërësor dhe zbatim të suksesshëm. Zhvillimi i mëtuqjeshëm i moduleve ekzistuese i mundëson Ministrisë së Shëndetësisë kontroll të plotë mbi sistemin dhe e lejon institucionin e kujdesit shëndetësor ta personalizoj atë sipas nevojave specifike. Gjithashtu kjo qasje mundëson fleksibilitet për të projektuar dhe përfshirë teknologjitë në zhvillim, duke i dhënë organizatës

së kujdesit shëndetësor më shumë fleksibilitet afatgjatë si dhe kosto më të ulëta afatgjata që përfshijnë mos blerjen e tarifave shtesë të licencimit. Kostot mund të jenë për mirëmbajtjen dhe ndërtimin/zhvillimin e moduleve dhe të veçorive të reja. Plani strategjik synon që zonimi do të përfshijë komponentë të ndryshëm për të shpërndarë në mënyrë efektive burimet e kujdesit shëndetësor dhe për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve si dhe në funksionalizmin e mëtejshëm të sistemit të transfuzionit të gjakut që është një komponent jetik, duke u fokusuar në menaxhimin e sigurt dhe efikas të produkteve të gjakut brenda sistemit të kujdesit shëndetësor.

5.1.4. **Objektiva specifike IV** Zhvillimi i sistemeve bazike mjekësore

Në kuadër të Objektivit Specifik IV Zhvillimi i sistemeve bazike mjekësore, për të garantuar efikasitetin e regjistrit elektronik mjekësorë në institucionet shëndetësore, sisteme të rëndësishme mjekësore bazike do të instalohen gjatë gjithë kësaj faze. Kjo bën të mundur mbledhjen e INFORMIMIT mjekësor të pacientit nga institucionet publike të kujdesit shëndetësor. Përveç instalimit LIS dhe RIS/PACS për institucionet me diagnostikim laboratorik dhe radiologjik, është planifikuar përmirësimi i BHIS dhe zbatimi i mëtejshëm për QKMF, QMF dhe ambulancat, zbatimi i sistemit të informimit të Menaxhimit të Spitaleve (HMIS), LIS dhe RIS/PACS do të bëhet në QKUK dhe spitalet e përgjithshme, vendosja e sistemit të e-Referimit dhe zbatimi i HMIS në të gjitha spitalet, përfundimi i EHR dhe ndërtimi i platformës HIE. Në mënyrë që të sigurohet ndërvepruesmëria ndërmjet komponentëve të ndërtimit, duhet të zbatohet gjithashtu një sistem master i menaxhimit të të dhënave. Sistemi statistikor i Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik dhe Sëmundjeve ngjitëse (IKSHPK) do të fillojë të zhvillohet dhe modifikimet e vazhdueshme të sistemit BHIS dhe sistemeve të tij mbështetëse (sistemi i trashëgimisë, Inspektorati) do të përfundojnë. Një EHR funksionale me të dhëna nga institucionet publike të kujdesit shëndetësor (përveç trajtimit të urgjencës stomatologjike dhe ambulatorë), si dhe një portal funksional për pacientët dhe një sistem e-Referimi duhet të vendoset deri në përfundimin e fazës, e cila është caktuar për vitin 2026.

5.1.5. **Objektiva specifike V** Zhvillimi i sistemeve e-shëndetësia

Në kuadër të Objektivit Specifik V Zhvillimi i sistemeve e-shëndetësia parashihet që të krijohen mekanizmat ku pacientët do të mund të nderveprojnë me sistemin e-shëndetësisë përmes kanaleve të ndryshme si portali i pacientëve dhe aplikacionet celulare. Përmes zbatimi të aktiviteteve të kësaj objektive specifike do të mundësohet rritja e përqindjes së vizitave të pacientëve në portalin e pacientëve nga përdorimi i portalit të njohurive për të përmirësuar qasjen në njohuri për menaxhimin më të mirë të gjendjeve të tyre kronike. Ata do të mund të hynë në të dhënat e tyre elektronike të shëndetit (EHR), të caktojnë takime, të marrin receta elektronike dhe të komunikojnë në mënyrë të sigurt me ofruesit e kujdesit shëndetësor si Spitalet, Klinikat dhe Farmacitë, që do të lidhen me sistemin e-shëndetësia nëpërmjet ndërfaqeve ose API-ve të ofruara. Shërbimet kryesore për qytetarët/pacientët – e-Referimi, Portali i pacientëve, sistemet për të mbështetur punën e punonjësve mjekësorë në kujdesin parësor, sekondar dhe terciar – si dhe infrastruktura bazë për sistemin kombëtar e-shëndetësia do të mundësohet me zbatimin e suksesshëm të aktiviteteve nga Faza I. Shumica e vendeve të BE-së që tani kanë sukses në zbatimin e e-shëndetësisë kanë ndjekur të njëjtat hapa (e- Recetë, kujdesi parësor, EHR), duke përfshirë Estoninë, Danimarkën dhe Kroacinë. Për shkak të synimeve ambicioze me planin strategjik dhe numrit të aktiviteteve të njëkohshme,

rreziqet kryesore në këtë fazë janë burimet e kufizuara njerëzore. Mbi këtë është planifikuar zbatimimi i plotë i recetës elektronike, si dhe zhvillimi i disa moduleve të reja (Inspektorati, Mbikëqyrja, Zonimi - përzgjedhja digjitale e mjekut, portali i pacientit).

5.1.6. **Objektiva specifike VI** Zhvillimi i Harduerit

Në kuadër të Objektivit Specifik VI Zhvillimi i harduerit parashihet që të sigurohet një infrastrukturë e duhur harduerike (serverët, PC-të, rrjetet, printerët, etj.) që është e rëndësishme kyçe për zhvillimin e sistemit të Informimit shëndetësor. Kjo do të mundësohet përmes një vlerësimi të plotë të infrastrukturës ekzistuese të TI-së dhe identifikimit të përmirësimeve ose investimeve të nevojshme si gjendja e harduerit, aplikacionet softuerike, infrastruktura e rrjetit, kapacitetet e ruajtjes së të dhënave dhe masat e sigurisë të nevojshme për të mbështetur zhvillimi dhe integrimi i sistemit të Informimit shëndetësor. Për më tepër, krijimi i infrastrukturës së nevojshme harduerike është thelbësor për të mundësuar zbatimin e të gjitha aktiviteteve për zhvillim të sistemit të Informimit shëndetësor. Infrastrukturë e fortë teknike duke përfshirë harduerin, softuerin dhe infrastrukturën e rrjetit. Kjo mund të ndihmojë që sistemi të jetë i besueshëm, i sigurt dhe i ndërveprueshëm me sistemet e tjera të kujdesit shëndetësor. Plani strategjik, gjatë fazës së zbatimit (2024-2030), parashihet që harduer të blihet/instalohet gjatë dy viteve të para të periudhës së vëzhguar, për rreth 9% të kostove totale të parashikuara.

5.1.7. **Objektiva specifike VII** Përmirësimi i sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave të tij

Në kuadër të objektives specifike VII Përmirësimi i sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave të tij parashihet fillimisht të sigurohet një analizë të mangësive për të identifikuar fushat ku masat aktuale të sigurisë kibernetike të SISH-it duhet të përmirësohen për të qenë në përputhje me Ligjin e Kosovës për Sigurinë Kibernetike. Ky objektivi specifik parashihet krijimin e një strukture të dedikuar qeverisëse të sigurisë kibernetike brenda kornizës së menaxhimit të SISH-it dhe zhvillimi i një plani gjithëpërfshirës të reagimit ndaj incidentit në përputhje me kërkesat e ligjit. Për të siguruar zbatimin e kësaj objektive parashihet Zhvillimi dhe zbatimi i trajnimeve të detyrueshme për vetëdijësimin për sigurinë kibernetike për përdoruesit SISH-it. Aktivitetet detale janë të shpalosura në planin e veprimit.

6. ARANZHIMET E ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT

Zhvillimi dhe funksionalizimi i sistemit të Informimit shëndetësor është proces kompleks afat-gjatë që në vete ngërthen përfshirjen e shumë aktorëve të sektorit shëndetësor dhe sektorëve. Ministria e Shëndetësisë do të jetë bartëse e aktiviteteve të zhvillimit dhe funksionalizimit të sistemit të Informimit shëndetësor dhe është përgjegjëse për zbatimin planit të veprimit të planit strategjik për zhvillimin e sistemit të Informimit shëndetësor. Duke marrë parasysh dimensionin e gjerë të sistemit të Informimit shëndetësor dhe përfshirjen e tij si proces brenda agjendës digjitale të Republikës së Kosovës roli i mekanizmave qendror dhe grupeve të interesit do të je kyç. Për këtë qëllim zbatimi i Planit strategjik për zbatimin e sistemit të Informimit shëndetësor 2024-2030 do të mbikëqyrët nga një mekanizëm ndër institucional i themeluar me vendim të qeverisë së Republikës së Kosovës për të siguruar pjesëmarrjen e të gjithë vendim-marrësve dhe grupeve të interesit që në veçanti kanë të bëjnë procesin e digjitalizimit.

Plani strategjik për zhvillim të sistemit të Informimit shëndetësor 2024-2030 në kuadër të aktiviteteve të parapara prioritet i jep veprimeve që për synim final kanë qytetarin/ pacientin. Për të arritur zbatimin e synimeve të këtij plani Ministria e Shëndetësisë do të vazhdoj bashkëpunimin me institucionet relevante në nivel nacional dhe lokal si dhe me partnerët tjerë strategjik për të avancuar më tutje këtë mekanizëm jetik që mundëson vendim-marrjen bazuar në dëshmi të sektorit të shëndetësisë. Brenda periudhës kohore 2023-2030 pritet mbështetje e vazhdueshme e qeverisë dhe partnerëve strategjik , qoftë përmes mekanizmave të financimit, por edhe ofrimit të asistencës teknike të nevojshme.

Ministria, për të zbatuar këtë plan strategjik të interesit nacional është duke vlerësuar opsione dhe alternativa për resurset e nevojshme për zbatimin të planit strategjik. Duke vlerësuar rolin e shoqërisë civile, Ministria synon vazhdimin e bashkëpunimit me organizata që jo qeveritare që në kuadër të fushëveprimit të tyre kanë të vendosur edhe sektorin e shëndetësisë.

Dokument plotësues i Planit strategjik do të jetë plani i veprimit i cili do të përfshijë periudhën kohore trevjeçare, 2024-2026, me mundësi të rishikimit vjetor varësisht nga përmbushja e aktiviteteve të planifikuara për periudha të ndryshme kohore. Gjithsesi se plani i veprimit do të parashohë edhe aktivitetet të cilat parashihet të zbatohen në periudhën 2026-2030 që do të mbulohen financiarisht sipas planifikimit të rregullte në kuadër të Kornizës Afatmesme të shpenzimeve.

Plani i veprimit paraqet një dokument përmbledhës të të gjitha aktiviteteve të propozuara me studimin e fizibilitetit 2023, për zhvillimin dhe funksionalizimin e sistemit të Informimit shëndetësor. Plani i veprimit në kuadër të Planit Strategjik për zhvillim të sistemit të Informimit shëndetësor 2024-2030 ofron detaje rreth aktiviteteve për arritjen e Objektivave të përcaktuara specifike, afatin kohor për arritjen e këtyre objektivave, Institucionet përgjegjëse për zbatim, indikatorët për monitorim dhe vlerësim të tyre, koston dhe bartësit e koston për realizimin e aktiviteteve të cilat janë të planifikuara në Kornizën afatmesme të shpenzimeve 2024-2026.

Është më rëndësi që politikat nacionale të mbështetën në vendime qeveritare për t'i dhënë reformave kuptimin e duhur në aspektin financiar, ligjor si dhe përcaktimin e duhur kohor. Për të arritur një zbatim të suksesshëm, është e nevojshme të përfshihen të gjithë aktorët relevantë për zbatimin e planit strategjik për zbatimin e sistemit të Informimit shëndetësor 2024-2030.

6.1. Monitorimi i zbatimit të planit strategjik

Ky kapitull do të ofrojë informata lidhur me shpeshësinë e monitorimit dhe raportimit, si dhe fokusin dhe procedurat. Bazuar në raportet e progresit dhe në varësi të kompleksitetit të dokumentit strategjik, përcaktohet rishikimi dhe vlerësimi i ndërmjetëm i planeve të veprimit, duke përfshirë fushën e rishikimit dhe afatin kohor. Krijimi i mekanizmave për monitorimin dhe vlerësimin e dokumenteve strategjike mundëson hartimin e politikave shëndetësore dhe vendimmarrjes së bazuar në të dhënat në dëshmi.

Ministria do të bëjë monitorimin e vazhdueshëm të indikatorëve Planit strategjik për zhvillimin e sistemit të Informimit shëndetësor 2024-2030, me të njëjtin mekanizma që parshihen për monitorimin e Strategjisë Sektoriale Shëndetësore 2023-2030 duke përdorur instrumente të qarta si: matriksi, manuali dhe plani i punës për monitorim dhe vlerësim. Bazuar në gjetjet, do të përgatitet një raport periodik dhe rekomandime për përmirësimin e vazhdueshëm të këtij segmenti duke marrë në konsideratë dhe shfrytëzuar qasje inovative dhe duke aplikuar shembuj të mirë nga vendet e tjera.

Monitorimi i Kornizës logjike dhe PV-së duhen bërë sipas sistemit monitorues për të cilin MSh-ja është përcaktuar dhe i cili ndjek modelin e kornizës logjike apo të menaxhimit të bazuar në rezultate. Ministria në Kornizën logjike ka përcaktuar indikatorët e matshëm, specifik, të arritshëm, e relevantë (SMART), të cilët kanë të përcaktuar elementet sasiore, cilësore dhe afatet kohore të realizimit. Për këta indikatorë janë mbledhur të dhëna për gjendjen aktuale të indikatorit, për të matur saktësisht nivelin e progresit pas intervenimit sipas logjikës së përcaktuar në Kornizën logjike. Përveç kësaj, secili indikator do të ketë formularin identifikues, në të cilin definohej saktësisht detajet e indikatorit, shkalla e përfshirjes, spektri, mënyra e matjes, institucionet përgjegjëse për zbatim, për mbledhje, agregim, dhe analizim të dhënash, si dhe afatet kohore.

Duke u bazuar në indikatorët kyç të definuar në Planin strategjik dhe në PV, Ministria do të bëjë monitorimin e vazhdueshëm të arritjes së rezultateve dhe aktiviteteve që ndërlidhen me objektiven strategjike dhe objektivat specifike, duke siguruar që institucionet dhe departamentet përgjegjëse të ofrojnë llogaridhënie në rast të moszbatimit të detyrave dhe aktiviteteve të planifikuara.

Monitorimi do të bëhet në dy nivele:

Monitorimi i aktiviteteve, me të cilin përcaktohet nëse aktivitetet janë kryer në kohën e duhur dhe në cilësinë e duhur. Mjeti kryesor për monitorimin e aktiviteteve është plani i veprimit, i cili përcakton kalendarin e zbatimit për secilin aktivitet. Sa herë që veprimtaritë e ndryshme devijojnë nga orari i tyre, duhet të shihet se a ka pasoja për veprimtaritë dhe burime të tjera. Arsyet e devijimeve të tilla duhet analizuar, ndërsa plani i zbatimit duhet të korrigojë në aspektin kohor. Nëse vonesa e aktiviteteve ndikon në orarin e zbatimit të aktiviteteve të tjera, atëherë Ministria duhet të reagojë duke i përshtatur planet dhe, duke bërë rindarjen e burimeve ekzistuese. Burimet duhet të jenë në dispozicion në kohën e duhur, edhe atë me cilësi dhe sasi të duhur. Koha e nevojshme për t'i siguruar burimet shpesh nënvlerësohet. Kjo ka të bëjë me burimet njerëzore dhe ato fizike. Për të siguruar likuiditetin e zbatimit, duhet monitoruar vazhdimisht sasia e fondeve që janë në dispozicion, përfshirë situatën në buxhetin publik, etj.

Monitorimi i objektivës bazohet në treguesit e tyre. Treguesit kanë vlerën bazë, synimin e ndërmjetëm dhe synimin e vitit të fundit në përputhje me periudhën e dokumentit strategjik. Që monitorimi të jetë efektiv, synimet e ndërmjetme duhet të caktohen në baza vjetore, duke u bërë pjesë e planit vjetor të punës. Atëherë, përfundimi nxirret përmes krahasimit të vlerës aktuale me synimin e përcaktuar.

Për vlerësimin e rezultateve të arritura, sfidat eventuale në zbatimin dhe adoptimin me procesin e planifikimit buxhetor do të bëhen përmes përditësimit vjetor të PV-së dhe raportimit të rregullt lidhur me ecurinë e zbatimit.

Raporti gjashtëmujor përgatitet deri në fund të muajit pas periudhës raportuese. Raporti i parë i gjysmë vjetorit mbulon 6 muajt e parë të vitit, ndërsa raporti i dytë i gjysmë vjetorit përfshinë periudhën prej 12 muajsh. Raporti fokusohet në përfundimin e veprimeve siç parashihen në planin e veprimit, arsyet për vonesa, rreziqet që lidhen me zbatimin e veprimeve dhe hapat e ardhshëm. Në vijim është dhënë formati i përgjithshëm i raportit gjashtëmujor:

- Plani i punës për periudhën e raportimit
- Përshkrim narrativ i punës së bërë aktualisht
- Përshkrimi i problemeve të hasura dhe shpjegimet e shrangieve të mëdha nga plani i punës
- Përmbledhje e shpenzimeve të planifikuara për gjashtëmujorin e shoqëruar me ndonjë koment apo shpjegim
- Rekomandim për përmirësimin e planit të zbatimit, ndryshimin e masave, buxhetit, etj.
- Plani i punës për periudhën e ardhshme gjashtëmujore.

Raporti vjetor përgatitet deri në fund të tremujorit të parë të vitit vijues. Fokusi i raportit vjetor është si vijon:

- Arritja e objektivave krahasuar me objektivat e treguesit (të paktën për dy vitet e fundit)
- Përfundimi në kohë i veprimeve të ndërmarra
- Përdorimi i burimeve financiare
- Pengesat kryesore në zbatim
- Masat korrektuese.

6.2. Vlerësimi i zbatimit të Planit strategjik

Vlerësimi është procesi më i hollësishëm për të analizuar suksesin e zbatimit të strategjisë, duke identifikuar se çfarë ka shkuar mirë, duke shqyrtuar arsyet prapa asaj që ka shkuar keq dhe pastaj duke ri-përshtatur drejtimin strategjik në përputhje me rrethanat. Dizajni dhe ekzekutimi i fazës së vlerësimit zakonisht është i pavarur nga korniza e rregullt e monitorimit dhe raportimit. Vlerësimi përfshin përpilimin e pyetjeve të vlerësimit, mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për të marrë përgjigjet e këtyre pyetjeve, dhe mbledhjen e provave për të formuluar përfundimet dhe rekomandimet.

Dimensionet e vlerësimeve do të jenë si më poshtë:

Relevanca - përputhshmëria e qëllimeve dhe objektivave të programit me nevojat e qytetarëve dhe prioritetet e Qeverisë;

Efektiviteti - përputhja e rezultateve të arritura të strategjisë me rezultatet e planifikuara si dhe nevojat e përfituesve të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë;

Efikasiteti - arritja e rezultateve me kostot më të ulëta (duhet të përcaktohet raporti i rezultateve me kostot (resurset) e kërkuara ose të përdorura për arritjen e tyre, do të përcaktohet);

Zbatimi - cilësia e procesit dhe strukturave të zbatimit;

Ndikimi - ndikimet e qëllimshme dhe të paqëllimshme;

Qëndrueshmëria - rezultatet afatgjata dhe ndikimet në strategji.

7. NDIKIMI BUXHETOR DHE ZBATIMI I STRATEGJISË

Ministria e Shëndetësisë (MSH) ka përgatitur vlerësimin e ndikimit buxhetor për planin Strategjik për zhvillimin e sistemit të Informimit shëndetësor 2024-2030 dhe planin e veprimit 2024-2026. Është vlerësuar se kostoja për zbatim të saj është në vlerë prej 52.979.000 . 00 € për vitet 2024-2030, ku përfshihet edhe kosto totale e mirëmbajtjes së parashikuar (software) në vlerë 18.791.000 €.

Plani strategjik parasheh që, gjatë gjithë periudhës së (2024-2030), rreth 39% e kostove totale të shpenzohen për projektet e shërbimeve elektronike ku shumica e tyre do të zbatohen në fund të periudhës, pasi të kenë përfunduar projektet më prioritet, duke përfshirë harduerin (HW), që parashihet të blihet/instalohet gjatë dy viteve të para të periudhës së vëzhguar, për rreth 9% të kostove totale të parashikuara. Pjesët relativisht më të rëndësishme dhe më prioritet të të gjithë ekosistemit e-shëndetësia – sistemet thelbësore mjekësore, duhet të përfshijnë rreth 33% të kostove totale të parashikuara (përfshirë mirëmbajtjen, pasi softueri të jetë ndërtuar/blerë dhe zbatuar).

Plani i veprimit për zbatimin e Planit Strategjik të zhvillimit të sistemit të Informimit shëndetësor 2024-2030 do të krijoj kosto shtesë buxhetore në vlerë prej 41,853,410 € mbi ndarjet buxhetore të parapara me Ligjin Nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 dhe vlerësimet për vitet 2025-2026 për Ministrinë e Shëndetësisë si zbatuese e plani të veprimit.




Figura 1- Kostoja totale e objektivave specifike në %




Figura II- Kostoja totale e aktiviteteve në vit sipas objektivave specifike

Planit Strategjik gjithashtu paraqet rreziqe dhe sfida të mundshme, duke përfshirë nevojën për buxhete dhe burime adekuate që mund të shkaktojnë vonesa në zbatim. Numri i madh i aktiviteteve të ndërvarura kërkon aftësi kompetente të menaxhimit të projektit dhe personel shtesë. Përvoja nga vendet e tjera tregon se projekte të tilla mund të zgjasin më shumë se pesë vjet. Megjithatë, me buxhete dhe burime të mjaftueshme të siguruar për zbatim dhe prokurim publik efikas, sistemet mund të kompletohen brenda kornizës kohore të propozuar.

Financimi i planit strategjik është një çështje me interes publik dhe do të financohet sipas modeleve të financimit të kujdesit shëndetësor, duke ndarë mjete buxhetore në baza vjetor bazuar në planifikimin e rregullt të buxhetit. Digjitalizimi i kujdesit shëndetësor zakonisht përbën 3-5% të totalit të shpenzimeve të kujdesit shëndetësor. Megjithatë, përveç shumës, është thelbësore të sigurohet një burim i qëndrueshëm dhe i sigurt i të ardhurave pasi, si çdo infrastrukturë, përmirësimet dhe mirëmbajtja e vazhdueshme janë të nevojshme për ta mbajtur atë të dobishme dhe funksionale. Për më tepër, zbatimi i planit Strategjik, ngërthen nevojën që duhet të ndahen fonde të konsiderueshme fillestare të investimeve, duke kërkuar marrjen në konsideratë të burimeve alternative të financimit. Burimet e financimit të Planit Strategjik të zhvillimit të sistemit të Informimit shëndetësor 2024-2030 do të sigurohen përmes buxhetit të Shtetit dhe huanë e Bankës Botërore që mbulon 4 vitet e para të zbatimit.

Institucionet publike financohen nga qeveria dhe mund të kenë një buxhet të kufizuar për infrastrukturën dhe mirëmbajtjen e TI-së. Si rezultat, spitalet publike mund të mos kenë burime për të investuar në sistemet më të avancuara të IT, edhe nëse buxheti vjen nga fondet e qeverisë. Në të kundërt, institucionet private mund të kenë më shumë burime financiare dhe mund të përballojnë të investojnë në sistemet më të avancuara të TI-së, duke u dhënë atyre një avantazh konkurrues.

8. PLANI I INVESTIMEVE BAZUAR NË STUDIMIN E FIZIBILITETIT 2023

Zhvillimi i studimi të fizibilitetit për eHealth në Kosovë – Raporti Përfundimtar

Plani i Investimeve për vite (në Euro)

ID-ja e projektit	Emri i Projektit	Financuar nga	Vite						
			2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
1	Strategjia e eHealth	MSH	120.000	0	0	0	0	0	0
2	Konsulenca për konfigurimin e Organit Drejtues eHealth	MSH	126.000	54.000	0	0	0	0	0
3	Përcaktoni dhe optimizoni proceset në zbatimin dhe mbikëqyrjen e projekteve të eHealth	MSH	100.800	43.200	0	0	0	0	0
4	Zhvillimi i qendrës së thirrjeve të kujdesit shëndetësor (HCCC)	MSH	0	0	79.200	132.000	52.800	0	0
5	Zhvillimi i Qendrës së Inovacionit të Shëndetit Dixhital (DHIC)	Fondi/donacion i BE-së	0	0	60.000	60.000	30.000	0	0
6	Rinovimi i HW dhe blerjet e reja	MSH	1.974.000	2.726.000	0	0	0	0	0
7	Përmirësimi i BHIS + mirëmbajtja	Organi drejtues i eHealth	360.000	360.000	360.000	360.000	360.000	360.000	360.000
8	HMIS (Sistemi i Informacionit të Menaxhimit të Spitalit)	Organi drejtues i eHealth	1.400.000	1.050.000	1.400.000	700.000	700.000	700.000	700.000
9	LIS (Sistemi i Informacionit Laboratorik)	Organi drejtues i eHealth	444.000	333.000	444.000	222.000	222.000	222.000	222.000

200 |

ID-ja e projektit	Emri i Projektit	Financuar nga	Financuar nga						
			2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
10	RIS (Sistemi Informativ i Radiologjisë) duke përfshirë PACS (Sistemet e Arkivimit dhe Komunikimit të Fotografive)	Organi drejtues i eHealth	592.000	444.000	592.000	296.000	296.000	296.000	296.000
11	Përmirësimi i SMSF + mirëmbajtje	Organi drejtues i eHealth	120.000	120.000	120.000	120.000	120.000	120.000	120.000
12	Transfuzioni i gjakut IS, lidh TC rajonale	NCBTK	98.000	42.000	28.000	0	0	0	0
13	EHR + HIE	Organi drejtues i eHealth	1.050.000	1.400.000	1.400.000	700.000	700.000	700.000	700.000
15	Portali i pacientit	Organi drejtues i eHealth	225.000	225.000	300.000	150.000	150.000	150.000	150.000
16	e-Referimi	Organi drejtues i eHealth	50.000	200.000	50.000	50.000	50.000	50.000	50.000
17	Menaxhimit i të Dhënave Kryesore	Organi drejtues i eHealth	250.000	350.000	100.000	100.000	100.000	100.000	100.000
18	Sistemi Statistikor i Shëndetit Publik (SPHS)	IKSHPK	400.000	80.000	80.000	80.000	80.000	80.000	80.000
19	Sistemi i mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse	IKSHPK	250.000	50.000	50.000	50.000	50.000	50.000	50.000

ID-ja e projektit	Emri i Projektit	Financuar nga	2024 2025 2026 2027 2028 2029 2030						
			2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
20	Përmirësimi i sistemeve ekzistuese (Punonjësi shëndetësor, specialist, licencim)	Organi drejtues i eHealth	250.000	50.000	50.000	50.000	50.000	50.000	50.000
21	Zonimi	MSH	150.000	30.000	30.000	30.000	30.000	30.000	30.000
22	Mbështetja e kapitationit në HIFIS	FSHF	35.000	25.000	10.000	10.000	10.000	10.000	10.000
23	Mbështetje DRG në HIFIS	FSHF	60.000	150.000	90.000	60.000	60.000	60.000	60.000
24	Inspektorati	MSH	210.000	150.000	60.000	60.000	60.000	60.000	60.000
25	Integrimi i të dhënave të KMA me MDM	KMA	30.000	120.000	30.000	30.000	30.000	30.000	30.000
26	Stomatologjia	Organi drejtues i eHealth	0	0	50.000	200.000	250.000	100.000	100.000
27	Sistemi i informacionit të kujdesit shëndetësor emergjent (EHIS)	Organi drejtues i eHealth	0	0	100.000	400.000	500.000	200.000	200.000
28	Moduli i transfuzionit në spitale	NCBTK	0	0	0	196.000	140.000	56.000	56.000
29	Përmirësimi i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Mikrobiologjisë (MIMS) (IKSHPK)	Organi drejtues i eHealth	0	0	24.000	216.000	48.000	48.000	48.000

ID-ja e projektit	Emri i Projektit	Financuar nga	Financuar nga						
			2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
30	e-Appointment	Organi drejtues i eHealth	0	0	0	280.000	200.000	80.000	80.000
31	Integrimet EHR me ofruesit privatë	Organi drejtues i eHealth	0	0	20.000	100.000	80.000	40.000	40.000
32	E-Receta duke përfshirë farmacitë private	Organi drejtues i eHealth	0	0	0	240.000	360.000	120.000	120.000
33	e-Vizitat	Organi drejtues i eHealth	0	240.000	240.000	240.000	120.000	120.000	120.000
34	Telekonsulta (ndërmjet personelit mjekësor)	Organi drejtues i eHealth	0	0	30.000	270.000	60.000	60.000	60.000
35	Telemonitorimi	Organi drejtues i eHealth	0	0	80.000	320.000	400.000	160.000	160.000
36	Sistemi Statistikor i Shëndetit Publik (SSHS) 2.0	IKSHPK	0	0	20.000	180.000	40.000	40.000	40.000
37	Sistemi analitik (DWH)	Organi drejtues i eHealth	0	0	0	280.000	420 mijë	140.000	140.000
38	Gjurmimi	Organi drejtues i eHealth	0	0	0	80.000	720.000	160.000	160.000

ID-ja e projektit	Emri i Projektit	Financuar nga	Financuar nga						
			2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
39	Regjistrat kombëtarë të shëndetit publik (diabeti, kanceri, HIV, TBC,...)	IKSHPK	0	0	0	260.000	390.000	130 mijë	130.000
40	Softueri i qendrës së thirrjeve (CCS)	MSH	0	0	30.000	270.000	60.000	60.000	60.000
41	e-Radiologjia - Depoja qendrore kombëtare e imazheve të radiologjisë dixhitale	Organi drejtues i eHealth	0	0	0	0	0	600.000	120.000
42	Zhvillimi i zgjidhjes së AI për triazhimin e pacientëve	Organi drejtues i eHealth	0	0	0	0	0	100.000	400.000
43	e-Pathways: Sistemi i informacionit i udhëzimeve të kujdesit shëndetësor	Organi drejtues i eHealth	0	0	0	0	0	160.000	240.000
44	Sistemet e mbështetjes së vendimeve klinike (CDSS)	Organi drejtues i eHealth	0	0	0	0	0	600.000	1.400.000
45	Sistemet e mbështetjes së vendimeve për barnat (DDSS)	Organi drejtues i eHealth	0	0	0	0	0	300.000	1.200.000
46	Sistemet mbështetëse të vendimeve të imazhit (IDSS)	Organi drejtues i eHealth	0	0	0	0	0	240.000	960.000
47	e-Mjekimi: sistem informacioni i integruar për menaxhimin profesional dhe ekonomik të mjekimit	Organi drejtues i eHealth	0	0	0	0	0	800.000	0
ID-ja e projektit	Emri i Projektit	Financuar nga	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
48	Shkëmbimi i të dhënave të pacientëve ndërkuftar	Organi drejtues i eHealth	0	0	0	0	0	0	500.000
TOTAL			8.294.800	8.242.200	5.927.200	6.792.000	6.938.800	7.382.000	9.402.000

Plani i veprimit për Sistemin e Informimit Shëndetësor									
Objektiva strategjike: Zhvillimi i Sistemit të Informimit Shëndetësor									
Objektiva specifike 1	Indikatorit (-#) për matjen e arritjes së objektivit				Baza 2024	Caku 2025	Caku 2026		
Zhvillimi i qeverisjes dhe administrimit	Korniza ligjore e plotësuar				0	20%	40%		
	Nr i të dhënave të menaxhuar në sistemin MDM								
	Nr i raporteve /të dhënave të gjeneruara nga sistemi statistikor i shëndetit publik								
	Nr i raporteve /të dhënave të gjeneruara nga sistemi mbikëqyres i sëmundjeve ngjitëse								
	Nr i indikatorëve të gjeneruar nga sistemi analitik DWH								
	Nr. i raporteve nga track and trace								
Nr i regjistrave funksional									
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucionet mbështetëse	Produkti	
		2024	2025	2026					
1.1 Zhvillimi dhe plotësimi i kornizes ligjore	TM4 2024	113,800.00 Euro	0	0	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	Kuvendi, Qeveria	Ligji për shëndetësi dhe aktet nënligjore të miratuara	
1.2 Dizajnimi dhe zhvillimi i sistemit Menaxhimi i të dhënave Kryesore - Master Data Managment	TM4 2024	250,000.00	350,000.00	100,000.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	KPSH, SHSKUK	Sistemi MDM i funksionalizuar	
1.3 Zhvillimi dhe zbatimi i sistemit statistikor i shëndetit publik	TM2 2024	400,000.00	80,000.00	80,000.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	IKSHPK	Sistemi statistikor i shëndetit publik i funksionalizuar	
1.4 Zhvillimi dhe zbatimi i sistemit mbikëqyres të sëmundjeve ngjitëse	TM1 2024	250,000.00	50,000.00	50,000.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	IKSHPK	Sistem mbikëqyres i sëmundjeve ngjitëse i funksionalizuar	
1.5 Dizajnimi dhe zhvillimi i Sistemit analitik-Data wareHouse DWH	TM4 2027	0	0	0	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	IKSHPK	Sistemi DWH i funksionalizuar	
1.6 Funksionalizimi i track and trace për barna dhe pajisje mjekësore	TM3 2027	0	0	0	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	AKPPM, Dogana e Kosovës, KPSH, SHSKUK, FSSH	Sistemi track and trace i funksionalizuar	
1.7 Dizajnimi dhe zhvillimi i sistemit per regjistrat kombëtarë të shëndetit publik	TM1 2027	0	0	0	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	IKSHPK	Nr i regjistrave në sistem	
Objektiva specifike 2	Indikatorit (-#) për matjen e arritjes së objektivit				Baza 2024	Caku 2025	Caku 2026		
Zhvillimi i kapaciteteve administrative	Raporët nga komiteti mbikëqyres për zbatimin e planit strategjik të SISH				0%	5%	30%		
	Nr i thirrjeve në qendrën e thirrjeve								
	Raporët nga kompania për zbatimin e aktivitetëve sipas kontratës								
	% e të trajnuarëve për sistemet								
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucionet mbështetëse	Produkti	
		2024	2025	2026					
2.1 Themelimi i komitetit mbikëqyres për sistemin e informimit shëndetësor - ehealth body	TM1 2024	126,000.00	54,000.00	0.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	Qeveria	Komiteti i themeluar dhe funksional	
2.2 Themelimi i qendrës së thirrjeve të kujdesit shëndetësor	TM3 2026	0.00	0.00	79,000.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	KPSH, SHSKUK	Qendra e thirrjeve të kujdesit shëndetësor e themeluar	
2.3 Themelimi i qendrës së inovacionit të shëndetit dixhital	TM3 2026	0.00	0.00	60,000.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	KPSH, SHSKUK	Qendra e inovacionit të shëndetit dixhital e themeluar	
2.4 Angazhimi i kompanisë për zbatimin e fazes së parë të zhvillimit të SISH	TM4 2024	100,000.00	200,000.00	200,000.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë		Kontraktimi i Kompanisë	
2.5 Trajnime për administratorët e sistemeve, profesionistëve shëndetësor	TM4 2025	0.00	200,000.00	400,000.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	KPSH, SHSKUK	Nr i stafit të trajnuar	

Objektiva specifike 3	Indikator (ë) për matjen e arritjes së objektivit				Baza 2024	Caku 2025	Caku 2026	
Zhvillimi i sistemeve mbështetëse	Nr i ISH që zbatohet modulën e punëtorit shëndetësor				15%	25%	30%	
	Nr i Institucioneve Private Shëndetësore që zbatohet modulën e licencimit të IPSH							
	Nr i specialistëve/mentorët klinik që zbatohet modulën e specialistëve,							
	Nr i ISH që zbatohet zonimin,							
	Nr i pagesave të aplikuara sipas kapitacionit							
	Nr i ISH që zbatohet DRG,							
	Nr i të dhënave të regjistruara në Inspektoriatin Shëndetësor,							
Nr i të dhënave të AKPM-se të integruar në MDM								
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucionet mbështetëse	Produkti
		2024	2025	2026				
3.1 Avancimi i sistemeve ekzistuese (moduli i punëtorit shëndetësor e, moduli i licencimit të Institucioneve Private Shëndetësore, moduli i specialistëve)	TM1 2024	250,000.00	50,000.00	50,000.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	KPSH, SHSKUK	Modulet funksionale
3.2 Funkcionalizim dhe avancimi i modulit për Zonim	TM2 2024	150,000.00	30,000.00	30,000.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	KPSH	Nr ISH që zbatohet zonimin
3.3 Zhvillimi i modulit për mbështetje teknike të mekanizmave për pagesë sipas performancës (kapitacionit) në SIF	TM2 2024	35,000.00	25,000.00	10,000.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	FSSH	Modul funksional për kapitacione
3.4 Zhvillimi i modulit për mbështetje DRG në SIF	TM1 2026	60,000.00	150,000.00	90,000.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	FSSH	Modul funksional për DRG
3.5 Zhvillimi dhe zbatimi i sistemit të Inspektoriatit Shëndetësor	TM4 2024	210,000.00	150,000.00	60,000.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë		Sistemi funksion i Inspektoriatit Shëndetësor
3.6 Avancimi i sistemit të Barnararit për shkëmbim të të dhënave	TM4 2024	30,000.00	120,000.00	30,000.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	AKPPM, KPSH, SHSKUK, FSSH	Sistemi funksional
Objektiva specifike 4	Indikator (ë) për matjen e arritjes së objektivit				Baza 2024	Caku 2025	Caku 2026	
Zhvillimi i sistemeve bazike mjekësore	Nr i ISH që zbatohet sistemin Bhis dhe nr i të dhënave të regjistruar në Bhis,				15%	30%	60%	
	Nr i ISH që zbatohet sistemin HMIS dhe nr i të dhënave të regjistruar në HMIS							
	Nr i ISH që zbatohet sistemin LIS dhe nr i të dhënave të regjistruar në LIS,							
	Nr i ISH që zbatohet sistemin RIS& PACKS dhe nr i të dhënave të regjistruar në RIS&PACKS							
	Nr. i barnatoreve në Institucionet Shëndetësore që zbatohet sistemin SMSF							
	Nr i Institucioneve Shëndetësore që zbatohet sistemin e transfuzionit të gjakut							
	Nr i Institucioneve Shëndetësore që zbatohet sistemin e stomatologjisë							
	Nr i Institucioneve Shëndetësore që zbatohet sistemin e kujdesit emergjent							
	Nr i ISH që zbatohet sistemin e mikrobiologjisë							
	Nr i ISH që zbatohet sistemin e Radiologjisë							
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucionet mbështetëse	Produkti
		2024	2025	2026				
4.1 Avancimi dhe mirëmbajtja e BHIS	TM1 2024	360,000.00	360,000.00	360,000.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	KPSH	Sistemi i avancuar i BHIS i funksionalizuar
4.2 Zhvillimi dhe zbatimi i sistemit spitalor - HMIS	TM4 2024	1,400,000.00	1,050,000.00	1,400,000.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	SHSKUK	Sistemi HMIS i funksionalizuar
4.3 Zhvillimi dhe zbatimi i sistemit laboratorik- LIS	TM4 2024	444,000.00	333,000.00	444,000.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	KPSH, SHSKUK	Sistemi LIS i funksionalizuar
4.4 Zhvillimi dhe zbatimi i sistemit RIS & PACKS	TM1 2024	2,000,000.00	1,800,000.00	0.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	KPSH, SHSKUK	Sistemi RIS & Packs i funksionalizuar
4.5 Avancimi dhe mirëmbajtja e SMSF-së	TM1 2024	120,000.00	120,000.00	120,000.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	KPSH, SHSKUK	Sistemi i avancuar i SMSF-së i funksionalizuar
4.6 Zhvillim dhe zbatimi i sistemit të transfuzionit të gjakut	TM2 2024	98,000.00	42,000.00	28,000.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	QKKTGJ, SHSKUK	Sistemi i transfuzionit të gjakut i funksionalizuar
4.7 Zhvillimi dhe zbatimi i sistemit të Stomatologjisë	TM4 2026	0.00	0.00	50,000.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	KPSH, SHSKUK	Sistemi i stomatologjisë i funksionalizuar
4.8 Zhvillimi dhe zbatimi i sistemit të kujdesit shëndetësor emergjent	TM4 2026	0.00	0.00	100,000.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	KPSH, SHSKUK	Sistemi i kujdesit emergjent i funksionalizuar
4.9 Avancimi i sistemit të mikrobiologjisë	TM3 2026	0.00	0.00	24,000.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	KPSH, IKSHPK, SHSKUK	Sistemi i avancuar i mikrobiologjisë i funksionalizuar
4.10 Zhvillimi dhe zbatimi i sistemit e-Radiologjia - Depoja qendrore kombëtare e imazheve të radiologjisë dixhitale	TM4 2028	0.00	0.00	0.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	KPSH, SHSKUK	Sistemi eRadiologjia i funksionalizuar
4.11 Zhvillimi i zgjidhjes së AI për triazhimin e pacientëve	TM4 2028	0.00	0.00	0.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	KPSH, SHSKUK	Sistemi i funksionalizuar

Objektiva specifike 5	Indikator (i-#) për matjen e arritjes së objektivit	Baza 2024	Caku 2025	Caku 2026
Zhvillimi i sistemeve e-shëndetësia	Nr i të dhënave të regjistruara në EHR dhe nr i të dhënave të shkëmbyera në mes të sistemeve	0%	5%	10%
	Nr i shërbimeve dhe nr i shfrytëzuesve në portalin e pacientëve,			
	Nr i referimeve të realizuara me sistemin e-referimi			
	Nr i termineve të caktuara në sistemin e-terminet			
	Nr i ISHP që zbatojn EHR			
	Nr i e-vizitave të realizuara me sistemin e-vizita			
	Nr i shërbimeve të ofruara nga sistemi e-Receta			
	Nr i telekonsultave të ofruar përmes sistemit Telekonsulta			
	Nr i telemonitorimeve të realizuara,			
	Nr i e-Pathways të dixhitalizuar			
	Nr e vendimeve në sistemin CDSS,			
	Nr i vendimeve në sistemin DDSS			
	Nr i vendimeve në sistemin IDSS			
	Nr i shfrytëzuesve të sistemit e-mjekimit			
Nr i pacientëve të regjistruar në sistem				

Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucionet mbështetëse	Produkti
		2024	2025	2026				
5.1 Zhvillimi dhe zbatimi i sistemit EHR+HIE	TM4 2024	1,050,000.00	1,400,000.00	1,400,000.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	KPSH, SHSKUK	Sistemi EHR+HIE i funksionalizuar
5.2 Avancimi i shërbimeve në portalin për pacient (eKosova)	TM1 2024	225,000.00	225,000.00	300,000.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	MPB	Portali i pacientëve i funksionalizuar
5.3 Zhvillimi dhe zbatimi i e-referimit	TM4 2024	50,000.00	200,000.00	50,000.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	KPSH, SHSKUK	Sistemi e-referimet i funksionalizuar
5.4 Zhvillimi dhe zbatimi i e-terminet	TM1 2027	0.00	0.00	0.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	KPSH, SHSKUK	Sistemi e-terminet i funksionalizuar
5.5 Integrimi EHR me Institucionet Shëndetësore Private	TM3 2026	0.00	0.00	20,000.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	KPSH, SHSKUK	Sistemi i funksionalizuar
5.6 Zhvillimi dhe zbatimi i e-Vizitat	TM1 2025	0.00	240,000.00	240,000.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	KPSH, SHSKUK	Sistemi e-vizita i funksionalizuar
5.7 Zhvillimi dhe zbatimi i e-Receta duke përfshi farmaceutë private	TM1 2027	0.00	0.00	0.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	KPSH, SHSKUK	Sistemi e-receta i funksionalizuar
5.8 Zhvillimi dhe zbatimi i Telekonsultave	TM4 2026	0.00	0.00	30,000.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	KPSH, SHSKUK	Sistemi i Telekonsultave i funksionalizuar
5.9 Zhvillimi dhe zbatimi i Telemonitorimit	TM3 2026	0.00	0.00	80,000.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	KPSH, SHSKUK	Sistemi i Telemonitorimit i funksionalizuar
5.10 Zhvillimi dhe zbatimi i e-Pathways- Sistemi i informacionit i udhëzimeve të kujdesit shëndetësor	TM2 2029	0.00	0.00	0.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	KPSH, SHSKUK	Sistemi e-Pathways i funksionalizuar
5.11 Zhvillimi dhe zbatimi i Sistemit të mbështetjes së vendimeve klinike (CDSS)	TM2 2029	0.00	0.00	0.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	KPSH, SHSKUK	Sistemi i mbështetjes së vendimeve klinike i funksionalizuar
5.12 Zhvillimi dhe zbatimi i Sistemit të mbështetjes së vendimeve për barnat (DDSS)	TM4 2029	0.00	0.00	0.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	KPSH, SHSKUK	Sistemi i mbështetjes së vendimeve për barnat i funksionalizuar
5.13 Zhvillimi dhe zbatimi i Sistemit mbështetëse të vendimeve të imazhit IDSS	TM4 2028	0.00	0.00	0.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	KPSH, SHSKUK	Sistemi mbështetëse të vendimeve të imazhit
5.14 Zhvillimi dhe zbatimi i e-Mjekimi: Sistem i integruar për menaxhimin e mjekimit	TM 4 2028	0.00	0.00	0.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	KPSH, SHSKUK	Sistemi e-Mjekimi i funksionalizuar
5.15 Zhvillimi dhe zbatimi i sistemit të shkëmbimit ndërkufitar i të dhënave të pacientëve	TM1 2030	0.00	0.00	0.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	MPB, MPJD, IKSHPK	Sistemi i shkëmbimit ndërkufitar i të dhënave të pacientëve i funksionalizuar
Objektiva specifike 6	Indikator (i-#) për matjen e arritjes së objektivit	Baza 2024	Caku 2025	Caku 2026				

Zhvillimi i Harduerit % I SHH të funksionalizuara me rrjet dhe pajisje të teknologjisë informative 60% 85% 100%

Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucionet mbështetëse	Produkti
		2024	2025	2026				
6.1 Vlerësimi i asetëve në Institucionet Shëndetësore	TM2 2024	0.00	0.00	0.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	KPSH, SHSKUK, IKSHPK	Asetet e vlerësuar
6.2 Ripërtirje e Harduerit dhe blerje të reja	TM2 2024	1,974,000.00	2,726,000.00	0.00	Buxheti i Kosovës	Ministria e Shëndetësisë	KPSH, SHSKUK, IKSHPK	Institucionet Shëndetësore të funksionalizuara me rrjet dhe pajisje

Objektiva specifike 7	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit				Baza 2024	Caku 2025	Caku 2026
	Afati i zbatimit	Kostoja totale			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucionet mbështetëse
	2024	2025	2026				
Përmirësimi i sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave të tij							
7.1 Kryerja e një analize të mangësive për të identifikuar fushat ku masat aktuale të sigurisë kibernetike të SISH-it duhet të përmirësohen për të qenë në përputhje me Ligjin e Kosovës për Sigurinë Kibernetike.	TM3 2024				Ministria e Shëndetësisë	MPB	Raporti mbi të gjeturat
7.2 Krijimi i një strukture të dedikuar qeverisëse të sigurisë kibernetike brenda kornizës së menaxhimit të SISH-it.	TM3 2024				Ministria e Shëndetësisë	MPB	Struktura qeverisëse
7.3 Zhvillimi i një plani gjithëpërfshirës të reagimit ndaj incidentit në përputhje me kërkesat e ligjit.	TM3 2024				Ministria e Shëndetësisë	MPB	Plani gjithëpërfshirës
7.4 Zhvillimi dhe zbatimi i trajnimeve të detyrueshme për vetëdijësimin për sigurinë kibernetike për përdoruesit SISH-it.	TM3 2024				Ministria e Shëndetësisë	MPB	Nr i të trajnuarëve
7.5 Zbatimi i masave të detyrueshme të sigurisë të përshkruara në ligj, duke përfshirë mbrojtjen firewall, sistemet e zbulimit/parandalimit të ndërhyrjeve dhe enkriptimin për mbrojtjen e të dhënave në pushim dhe në tranzit.	TM4 2024				Ministria e Shëndetësisë	MPB	
7.6 Kryerja e auditimeve fillestare gjithëpërfshirëse të sigurisë së infrastrukturës dhe aplikacioneve të SISH-it.	TM4 2024				Ministria e Shëndetësisë	MPB	Raportet e auditimeve
7.7 Zhvillimi dhe zbatimi i një plani njoftimi për shkeljen e të dhënave në përputhje me rregulloret përkatëse.	TM4 2024				Ministria e Shëndetësisë	MPB	Plani mbi njoftimin për shkeljen e të dhënave
7.8 Blerja dhe zbatimi i një sistemi të centralizuar të informacionit të sigurisë dhe menaxhimit të ngjarjeve (SIEM) për monitorim në kohë reale.	TM4 2024				Ministria e Shëndetësisë	MPB	Sistem funksional
7.9 Zbatimi i kontrollit të qasjes së bazuar në role (RBAC) për të dhënë qasje bazuar në funksionet dhe lejet e punës.	TM1 2025				Ministria e Shëndetësisë	MPB	
7.10 Kryerja e trajnimeve të specializuara për sigurinë kibernetike për përdoruesit me rrezik të lartë dhe administratorët e IT-se.	TM1 2025				Ministria e Shëndetësisë	MPB	Nr i të trajnuarëve
7.11 Iniciimi i pjesëmarrjen në iniciativat për shkëmbimin e inteligjencës së kërcënimeve dhe komunitetet e informacionit.	TM1 2025				Ministria e Shëndetësisë	MPB	
7.12 Programimi i vlerësimeve të rregullta të cënueshmërisë dhe testimeve të depërtimit për të identifikuar dhe adresuar dobësitë.	TM1 2025				Ministria e Shëndetësisë	MPB	
7.13 Zbatimi i verifikimit me shumë faktorë (MFA) për llogaritë e përdoruesve të SISH-it.	TM2 2025				Ministria e Shëndetësisë	MPB	
7.14 Zbatimi i simulimeve të rregullta phishing dhe fushata vetëdijësimi për sigurinë.	TM2 2025				Ministria e Shëndetësisë	MPB	
7.15 Zhvillimi dhe ofrimi i trajnimeve të specializuara për personelin e TI-së mbi procedurat e reagimit ndaj incidenteve	TM2 2025				Ministria e Shëndetësisë	MPB	Nr i të trajnuarëve

7.16 Kryerja e një rishikimi dhe përditësim të planit të reagimit ndaj incidentit bazuar në mësimet e nxjerra dhe praktikat më të mira.	TM2 2025			
7.17 Kryerja e auditimeve vijuese të sigurisë dhe vlerësimeve të cënueshmërisë për të adresuar dobësitë e identifikuar.	TM3 2025			
7.18 Pjesëmarrja në ushtrime të përbashkëta të sigurisë kibernetike dhe seminare trajnimi me partnerët.	TM3 2025			
7.19 Zhvillimi dhe zbatimi i masave shtesë të sigurisë bazuar në kërcënimet në zhvillim dhe praktikat më të mira.	TM3 2025			
7.20 Kryerja e programeve të vazhdueshme të vetëdijesimit dhe trajnimit për përdoruesit për të përforcuar praktikat më të mira të sigurisë kibernetike.	TM4 2025			
7.21 Përsosja dhe përditësimi i planit të njoftimit për shkeljen lidhur me të dhënat bazuar në përvojën dhe ndryshimet në rregullore.	TM4 2025			
7.22 Vlerësimi i efektivitetit të masave të sigurisë të zbatuara dhe kryerja e rregullimeve sipas nevojës.	TM4 2025			
7.23 Zgjerimi i bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare të sigurisë kibernetike.	TM4 2025			
7.24 Zhvillimi dhe zbatimi i planeve për përmirësimin dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të kornizës së sigurisë kibernetike të SISH-it.	TM4 2025			
7.25 Përgatitja dhe dorëzimi i raporteve mbi incidentet e sigurisë kibernetike dhe vlerësimet e rrezikut siç kërkohet nga ligji.	TM1 2026			
7.26 Zhvillimi dhe publikimi i një raporti vjetor të vetëdijesimit për sigurinë kibernetike dhe materiale për palët e interesit.	TM1 2026			
7.27 Kryerja e auditimeve të mëtejshme të sigurisë dhe testimeve të depërtimit për të ruajtur një mjedis të sigurt të SISH-it.	TM1 2026			
7.28 Përmirësimi dhe avancimi i planit të reagimit ndaj incidentit bazuar në mësimet e nxjerra nga incidentet e mëparshme.	TM1 2026			
7.29 Zbatimi i teknologjive të avancuara të sigurisë siç është planifikuar dhe integrimi i tyre me masat ekzistuese të sigurisë.	TM1 2026			
7.30 Kryerja e programeve të vazhdueshme të vetëdijesimit dhe trajnimit për përdoruesit për të adresuar kërcënimet dhe dobësitë e reja.	TM2 2026			
7.31 Vazhdimi i pjesëmarrjes në iniciativat për shkëmbimin e inteligjencës së kërcënimeve dhe komunitetet e informacionit.	TM2 2026			
7.32 Kryerja e një rishikimi përfundimtar të përputhshmërisë me Ligjin e Kosovës për Sigurinë Kibernetike për Institucionet Shëndetësore Publike.	TM3 2026			
7.33 Zhvillimi dhe zbatimi i masave shtesë të pajtueshmërisë sipas nevojës.	TM3 2026			
7.34 Zhvillimi i një strategjie afatgjatë të sigurisë kibernetike për SISH për të siguruar mbrojtje dhe përshatje të vazhdueshme.	TM4 2026			
7.35 Sigurimi i financimit dhe burimeve për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kornizës së sigurisë kibernetike të SISH-it.	TM4 2026			

4,921,739.00

Ministria e Shëndetësisë	MPB	Plani i përditësuar
Ministria e Shëndetësisë	MPB	Raportet e auditimit
Ministria e Shëndetësisë	MPB	Nr i seminareve.
Ministria e Shëndetësisë	MPB	
Ministria e Shëndetësisë	MPB	
Ministria e Shëndetësisë	MPB	Plani i përditësuar
Ministria e Shëndetësisë	MPB	
Ministria e Shëndetësisë	MPB	Nr i organizatave
Ministria e Shëndetësisë	MPB	Raportet
Ministria e Shëndetësisë	MPB	Raportet mbi incidentet e sigurisë kibernetike
Ministria e Shëndetësisë	MPB	Raporti vjetor
Ministria e Shëndetësisë	MPB	Raportet e auditimit
Ministria e Shëndetësisë	MPB	Plani i përditësuar i reagimeve
Ministria e Shëndetësisë	MPB	
Ministria e Shëndetësisë	MPB	Nr i të trajnuarëve
Ministria e Shëndetësisë	MPB	Nr i pjesëmarrjes
Ministria e Shëndetësisë	MPB	Raporti
Ministria e Shëndetësisë	MPB	
Ministria e Shëndetësisë	MPB	
Ministria e Shëndetësisë	MPB	